

BIBLIOTEKA  
SHTETIT

8JH-32

L89

PIRO LOLI

TREGIME



I DHJETI  
NGA TANET

814-32

            
L 89

PIRO LOLI

# I DHJETI NGA TANËT

— tregime —



1982

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

## I DHJETI NGA TANËT

Treni fishkëlleu dhe vagonat u tundën si me përtim. Në qiell lodronin ca re të lehta, të lehta dhe unë ndjeja një gëzim të brendshëm; ashtu kot, por më pëlqente të ëndërroja.

Ai hyri në kabinën tonë dhe kërkoi vend për t'u ulur.

— Uluni — i tha studentja që mbante dispensën në dorë.

Burri zuri vend në anën time. Ishte i gjatë, pak i hollë dhe rrinte si i ngrirë. Kjo dukej nga lëvizjet e ngadalshme që bënte. Pas pak burri futi dorën në xhëp dhe nxori paqetën e cigareve.

Vura re se dorën e kishte të djegur nga ana e brendshme e pëllëmbës.

Nuk e shikoja dot në fytyrë. Se si më vinte. Faqen e kishte të djegur dhe syrin pak të mbyllur në kënd ngaqë lëkura i ishte djegur dhe i ishte mbledhur.

Më dukej sikur do ta fyeja po ta shikoja drejt në fytyrë. Sytë pa dashur më vinin tek ajo lëkura e hollë dhe e ndritshme e faqes dhe te syri pak i mbyllur.

Ai më zgjati paqetën. Unë mora cigaren dhe nxitova t'ja ndizja.

— Nga je? — më tha.

— Nga Gjirokastra.

— Po ti?

— Nga Borova.

— Ë, hë, nga Borova...

— Ke qenë në Borovë?

— Jo, por kam dëgjuar për Borovën, Borova martire... Edhe këtë javë transmetoi radioja diçka për martirizimin e Borovës.

Unë e vështrova prapë plagën e faqes me lëkurën e hollë dhe ndjeva dhembje.

Kishte ngulur sytë nga dritarja dhe dukej sikur



numronte shtyllat që kalonin njëra pas tjetrës me shpejtësi.

— Domethënë ke dëgjuar ë... — përsëriti pas një heshtjeje. — Por nuk e ke parë, s'i ke njohur ata... S'ke ndjerë... S'të ka dhembur...

Unë i dhashë cigare dhe ai filloi të tregonte.

Ashtu copa-copa i lidhte mendimet. Ne të tjerët duhet t'i merrnim me mend disa gjëra se nuk e pyesnim dot. Nuk ishte gjë e lehtë ta pyesje si i qenë vrarë nëna, babai, vëllai, gjithë familja e tij.

«Gjermanët hynë në fshat duke vrapuar me automatikë nëpër duar. Më të hyrë, ata dogjën ca grumbuj me duaj dhe një arë me elb që nuk ishte korrur.

Në oborrin tonë hynë me breshëri plumbash. Siç duket dikush u kishte thënë që xhaxhai im ishte komisar. Ndaj u futën te ne aq të tërbuar.

Dhe atë ditë për disa minuta i vranë të tërë. Po, po, të tërë sa gjetën në shtëpi. Ata më vranë prindërit. Më vranë vëllanë. Më vranë motrën. Më vranë nusen e vëllait me tre fëmijë...

Nënë time plakë dhe një vajzë të vogël të vëllait i kanë shpuar me bajonetë...»

Unë me dy studentet që ishim në kabinë shtangëm nga ky rrëfim i papritur. Ai tregonte dhe gati në çdo fjalë shtrëngonte nofullat dhe një muskul i lëvizte në faqen e djegur.

Heshtje. Edhe ne heshtëm. Më rëndonte shumë heshtja. Ndjeja dhembje për këtë njeri që kishte humbur krejt familjen.

Ai kujtonte atë ditë...

«Në një dhomë ata gjetën nusen e vëllait me tre fëmijët.

Me një breshëri vranë dy fëmijët. Me një breshëri. Me një lehtësi të tillë sikur të shtinin kot mbi disa gurë të ngritur.

Nëna e tyre lëshoi një ulërimë dhe ju vërvit gjermanit në grykë. Por këmbët ju prenë ngaqë e shpoi plumbi dhe ra mbi fëmijët në atë pellg gjaku.

Edhé në çastet e fundit të jetës, ajo kërkonte fëmijët. Donte t'u prekte kokën, fytyrën, t'i mbante atje afër vetes.

I gjeti dy me duart që i dridheshin. Njërin nuk e gjeti. Cili mungonte vallë? Ata e kishin shpuar me bajonetë vajzën e vogël dhe e kishin nxjerrë në korridor...

Këto ishin vetëm disa çaste. Kjo ndodhi aq shpejt... , aq shpejt...

Babai im, plak njeri, kishte dalë nga dhoma dhe, duke mbajtur shkopin e tij me të dyja duart, ja kishte veshur njërit pas kokës. Gjermanit i plasi gjaku mbi qafë dhe mbi uniformë.

Ai e ngriti prapë shkopin por e vranë. Sikur ju këputën këmbët të shkretit plak, ashtu ra... por shkopin e ngriti prapë dhe me tëra forcat e fundit e vërviti mbi trupin e një gjermani tjetër.

Unë e mbaj mend shkopin e babait. Në krye të shkopit ai kishte gdhendur një shqiponjë me krahë të hapur.

I mbaj mend edhe grindjet e dy vajzave të vëlloit për atë shkop të lëmuar, të thantë. Grindeshin kush ta merrte. I shkreti baba, u thosh se do ta merrte ajo që do të pastrohej më bukur. Dhe ato rrinin të dyja te pasqyra, laheshin e kriheshin për të fituar shkopin.

Ajo e vogla... eh, sa e bukur! Ka pasur sy të kaltër, të kthjellët... babai ja jepte më tepër shkopin asaj tjetrës. Ndërsa këtë bukuroshen e merrte në duar dhe e përkëdhelte.

Yllka, kështu e kishte emrin, e përqafonte gjyshin dhe i thoshte:

— Gjysh, pse nuk i heq mustaqet si babi?

— Jo — i thosh ai — po t'i heq mustaqet unë vdes. Do ti, Yllka, të vdesë gjyshi?

— Jo, mos i hiq — i thosh Yllka. — Lëri të të bëhen kaq, kaq fare — dhe hapte krahët, pastaj e përqafonte fort dhe i thosh:

— Gjysh, unë të kam xhan mu këtu, këtu — duke treguar gushën e saj të bardhë — po kur do ma japësh shkopin mua?..

— Diku kam lexuar — tha një studente — për viktimat e fashizmit... Në Zvicër qe një familje që kishte humbur shtatëmbëdhjetë vetë...

«Nëna në ato çaste rrëmbeu një gotë dhe i ra njërit nga gjermanët. Mu në fytyrë i ra. Pastaj ata...

Vëllanë e vranë te shkallët. Ai ishte në punë, në të korra. Erdhi me drapër në dorë të mbronte familjen. Por njëri që rrinte në shkallë me automatik në dorë e qëlloi... Mua më kujtohet si sot ajo fytyrë. Ishte i veshur bukur, me uniformën e ushtarit gjerman, me gravatë të zezë. Ai qëllonte dhe dridhej. Hapte dhëmbët sa kohë që vazhdonte breshëria. Pastaj shante. Shante me një gjuhë të ashpër, të egër sikur thyente degë rrapi. Edhe vëllain tim e shau. E vrau dhe e shau. Me atë gjuhën e ashpër «Krrrau, krrrau!» sikur thyente degë të thata rrapi...

Po motra dhjetë vjeçe ishte. Ajo i binte violinës. Ja kishte mësuar xha Lamja. Xha Lamja kishte bërë shkollën jashtë shtetit dhe i binte violinës. Ai thosh për motrën se do të bëhej artiste... Motra këndonte bukur dhe i binte violinës. Babai shiti një dem dhe xha Lamja i bleu violinë... Motra ngrihej herët në mëngjez. Ajo na e mbushte mëngjezin me tinguj,

me zëra të ëmbël. Babai, i kërkonte gjithnjë këngën e Selam Musait.

Unë atëhere isha 15 vjeç.


Kur erdhën ata, unë u futa në mes të trëndafilave. Kemi pasur ca trëndafila të mëdhenj në fund të oborrit. Ata çelnin trëndafila të mëdhenj të kuq. Motra merrte mëngjez për mëngjez nga një tufë trëndafila.

Unë u struka në mes të trëndafilave. Kur dëgjova gjithë ato armë e ulërima në shtëpi, desha të ulërija, po nuk ulërija dot. Nuk më dilte asnjë fije zëri. Ndjeva se trupi më ishte ftohur. Sytë m'u veshën dhe nuk dalloja asgjë. Një dëshirë e madhe e domosdoshme më thoshte që të bërtisja, të ulërija, të qaja. Por jo. Nuk qaja dot. Lotët nuk më dilnin. Ata ishin tharë. Edhe zëri ishte ngjirur. Frikë nuk kisha. Bile doja të vritesha bashkë me të tjerët.

Pastaj i vunë zjarrin shtëpisë. E spërkatën brenda dhomë më dhomë me benzinë. Të gjithë thoshnin një fjalë «foko, foko, foko». Kështu më duket. Spërkatën gjithshka. Edhe të vrrarët brenda. Edhe trupin e vëllait të shkallët. Edhe enët e kuzhinës. Edhe violinën e motrës varur në mur. Edhe oborrin. Edhe trëndafilat... «Foko, foko, foko...», bërtisnin të tërë ata. Gjithshka mori flakë, shtëpia, oborri, të vrrarët, trëndafilat. Edhe unë kisha marrë flakë. U ndeza këtu, këtu, këtu». — Dhe tregonte dorën, ijet, supin, faqen, ballin...

Pas asaj dite më mori një fqinjë në shtëpi. Nuk mbaj mend sa ditë shkova me këto plagë të djegura. Por mua nuk më dhimbnin plagët. Më dhimbte shpirti thellë, thellë. Natën më dilte gjumi. Bërtisja në gjumë. Shikoja ëndrra të llahtarshme. Në fillim shikoja vetëm një ëndërr: Një gjerman i gjatë me flo-





kë të ngatërruar, me gravatë të zezë në njerën dorë mbante një urë të ndezur në tjetrën një bajonetë të larë me gjak. Ai më ndiqte nga pas dhe unë vrapoja në një rrugë të ngushtë, pa krye. Një gjerman tjetër me sy të kuq si dy thëngjij të ndezur më priste rrugën... Dhe unë bërtisja në gjumë me lemeri. Teto Olimbia zgjohej dhe më vinte te jastëku. Unë mërmëritja nëpër gojë dhe balli më mbulohej me djersë. Ajo merrte një peshqir të lagur dhe më ftohte ballin. Po mua nuk më zinte gjumi. Unë qaja. Qaja fshehtas, sepse nuk doja që të më shihte teto Olimbia. Një herë më pa dhe qau. Qau shumë. Ato net... Pasi më dilte gjumi unë bisedoja me nënën, babain, motrën, me të gjithë ata që u dogjën. Asnjërin nuk e përfytyroja dot me saktësi. Do të isha i lumtur ta kujtoja fytyrën e nënës. S'ka gjë, ashtu të vrarë.

... Por ata i dogjën trupat e tyre. Dhe unë nuk i merrja dot me mend si mund të dukeshin... Mundohesha t'i përfytyroja të gjithë si qeshnin, si i kishin sytë... Për çudi dy vajzat e vogla të vëllait i

përfytyroja te pasqyra kur kriheshin. Ajo e vogla më thosh gjithnjë në vesh: «Pa shih, a nuk jam unë më e bukura!? Mua më takojnë edhe shkopi i gjyshit, dhe violina e tezes...»

Ai ishte zhytur tërësisht në mendimet e tij. Instinktivisht thithte cigaren.

— Po komisari — tha studentja bionde...

— Ai u vra në Mal të Zi. E zuri luftën që nga Borova deri në Mal të Zi. Nga shokët e tij pat ardhur një letër, ku betoheshin se do t'ja merrnin hakun.

Kjo letër nuk gjeti asnjë njeri në shtëpi. Kush do të derdhte një lot?! Por befasi m'u shfaqën shokët e tij. Një fjalim i zjarrtë në kompani a batalion. Lot të nxehtë nga sytë e shokëve. Betimi. Ndonjë bre-shëri armësh!

Pastaj hakmarrja. E tmerrshme, e egër!

... Nëntë vetë nga një familje! Nëntë...

— Dola partizan. Në batalion e ndjeva veten më mirë — vazhdoi ai. — Atje kishte edhe të rinj të tjerë. Njëri ishte 12 vjeç. Mua më shikonin me vërejtje dhe tregonin dashuri. Kur më shikonin mua më dukej sikur thoshin të gjithë: «Ja, ky është ai djali që ja kanë vrarë gjithë familjen».

Një herë foli komandanti i batalionit për mua. Foli shumë. Unë rrija në rresht me të tjerët. Të gjithë rrinin gatitu. Se kështu rrinim në rresht, gatitu, me kokën drejt. Komandanti fliste dhe herë-herë batalioni ngrinte grushtin përpjetë. Një grusht të vetëm. Një grusht të vetëm dhe brohorima shpërthen-te nga gjoksi i batalionit.

Komandanti më fali një automatik. Automatikun e tij me qytë metalike.

«Merre, më tha, dhe të luftosh si shqiponjë, kupton, si shqiponjë»!

Unë e përqafova fort dhe ai më puthi në ballë.

... «kupton, si shqiponjë...»

Si duket prandaj e kishte gdhëndur babai im shqiponjën në shkopin e tij të thantë.

## RRUGA MBI KANUN

Bashkë me muzgun kishte hyrë në kullën e xha Frrokut malësori Pal.

— Sa dekorata të kanë dhënë — i tha Pali.

Frroku e nuhati mendimin e tij dhe u përgjegj.

— Shkoj me punue e jo për dekorata.

— Dëgjova që sot të kanë dhanë dekorata. Bile dy dekorata... dhe se t'i ka varë në gjoks një çikë.


Atë ditë vërtet ne kishim ndarë «S»-të. Në skuadrën tonë kishte marrë dy «S» dhe xha Frroku, që punonte me ne që nga dita e parë e aksionit. Atij ja vari në gjoks Diana, sekretarja jonë e rinisë. Xha Frroku ishte emocionuar dhe kishte mbajtur një fjalim të shkurtër.

— Luej vendit, Frrok. Ata... ata na kanë prek tepër... Lakuriq, Frroku, thuej se lakuriq me gjithë djem. Bobo, çikat e tyne! I kam pa me këta sy, Frrok. Ata na kanë turpnue Cemin!

— Folë, Pal!

— Çikat e tyne lakuriq, Frrok, në Cemin tonë, thuejse lakuriq bashkë me djem! Unë ndala në rrugë e m'u duk se më ranë malet mbi shpinë. Ato futeshin brenda në lum me djem... të zhveshuna, Frrok! Pastaj dolën dy e nga dy dhe rrinin majë

gurëve. Sikur të qe çika ime, pasha zotin, e kisha vra në vend! Që prej asaj dite unë s'kam shkue ma nga ajo rrugë dhe nuk kam me shkue derisa të mbarojë kjo e shkretë xhade.



— Qenke trembur nga çikat, or Pal!

— Nga turpi Frrok, e jo nga çikat. Ato na kanë turpnue malet, ku asht pa e ndie kjo? Na kanë turbullue Cemin, ku asht ndigjue kjo? A ka turp ma të madh, Frrok, të shikosh çikat lakuriq?! Dhe ti, Frrok, shkon me ta? A je në vedi, Frrok?! Ti me rininë? Faqja e zezë, Frrok!

— Ata janë djem e vajza të mira, Pal. — Unë punoj me ta. — Unë i kam pa vetë...

— Po çikat a i ke pa lakuriq?

Xha Frroku kishte mbetur i heshtur, me sytë ulur mbi truallin e kullës.

«Edhe çikat nuk janë fort të këqia, mendoi Frroku, por vetëm se qeshin pak si tepër... Në të vërtetë s'e ka keq Pali, ato duken sikur s'kanë turp... Sikur nuk u ban përshtypje mosha, meshkujt. Por duken të çiltëra, bre, sikur s'kanë gja të keqe në zemër. Ato punojnë, këndojnë...»

— Faqja e zezë, Frrok — tha malësori Pal dhe u largua si hije dredharake nëpër muzg.



Kur jepej sinjali i pushimit, zhurma jonë varej poshtë, drejt lumit. Dukej sikur gjithë xhadeja ishte mbushur me bisedat e studentëve.

Kur shkuam në fillim, lumi na dukej shumë i ftohtë, megjithëse korriku digjte.

Shoqet përvishnin pantallonat prej doku dhe rrinin në anë të rrjedhës duke freskuar pulpat dhe llërët.

«Freskohet bukuria në currila ylberësh të ftohtë», kishte shkruar në një vjershë, poetesha Florë. Vetëm xha Frroku nuk varej në lumë. Rrinte atje, te vendi i punës ai. I menduar, i heshtur, si të donte t'u gjente fillin bisedave që kishte bërë me ne. Bisedat tona e shqetësonin atë. I dukej sikur kishin prekur gjithë botën e tij të fortë dhe të vjetër. Dhe atje tek rrinte i vetmuar shoshiste me mendjen e tij gjithshka të re që kishte dëgjuar dhe kishte parë. Ndoshta i rëndej e tatëpjeta. Xha Frroku ishte shumë i gjatë, pak i kërrusur nga vitet dhe gjunjët e hollë i jepe-shin sikur nuk do ta mbanin dot. Ndoshta...

Ne në grup kishim katër çifte të fejuara. Ata rrinin afër njëri-tjetrit, bisedonin, ëndërronin me shikim të zhytur në dallgët e kaltëra.

Xha Frroku nuk i shikonte me sy të mirë çiftet tona. Dukej sikur ai bluante një farë urrejtje të brendshme për shoqet tona, për çiftet.

Çuçuriste Cemi dhe përcillte poshtë, grykë më

grykë xhadenë që po zgjatej para, normat, bisedat e studentëve, dashuritë, subjektet e letrarëve. Ne punonim me vrull të madh.

Ishim zotuar para një shoku të Komitetit Qendror që xhadenë ta mbaronim para kohe. Ajo çante përpara me shpejtësi. Shpesh në mes të xhadesë dilnin shkëmbenj të mëdhenj sa një kodër. Dukeshin sikur shkëmbenjtë i thoshin xhadesë: «Ndal! Këtu jemi ne»! Po skuadra e minatorëve ua shponte zemrën dhe i mbushte me dinamit. Pastaj ne vërshonim të gjithë dhe i rrokullisnim copat e shkëmbit në pjerrësitë e Cemit. Shkëmbenjtë binin me vërtik në kaltërsitë e Cemit.

Malet ngriheshin të mëdha, të larta, sikur donin të ngushtonin xhadenë tonë. Pjella më e bukur e këtyre maleve dukej ajo rrjedhë e kaltër, e shpejtë dhe e ftohtë, Cemi. Thoshin se ky lumë buronte nga zemra e një mali. Por malet të gjitha shtrydhin gjitë e ftohtë dhe ushqejnë Cemin. Tashmë bukurisë së egër të këtyre maleve po u shtohet paralelisht me Cemin edhe xhadeja jonë. Xhadeja ngjitej pjerrësive të maleve me vështirësi. Një skuadër e jona punonte në shpatullat e një shkëmbi gjigant lidhur me litarë.



- Pse nuk ka ardhur sot xha Frroku?
- Duhet të vijë
- Thonë se është zemëruar me ne dhe nuk do të vijë më.
- Mos e kemi fyer gjë? Këta malësorët preken shpejt.

— S'është e vërtetë — u hodh Zakua — është bërë zakon që, kur shkruajmë ose flasim për malësorët, i paraqitim të egër si malet, me sedër të fortë, patriarkalë e ku di unë se çë.

— More, po lërin filozofimet. I njohët ju malësorët me një muaj. . .

— Sidoqoftë në skuadrën tonë mbaroi intriga — tha poetesha Flora.

— Pse? Ç'intrigë?

— Kanuni nuk i qëndroi dot së resë dhe u mbështoll në kullë — vazhdoi Flora.

Unë sepse grindesha shpesh me Florën. Kisha qejf ta kundërshtoja deri në një. Por nga ana tjetër më pëlqente të diskutoja me të. Flora kishte talent dhe mua disa poezi të saj më kishin pëlqyer. Ndoshta më pëlqente se që dhe e bukur shejtanka.

— Domethënë zotrote — i thashë unë — xha Frokun, malësorin, e barazon me fjalën «kanun».

— Dhe Diana që i dha dy «S»-të xha Frrrokut ja paska dhënë vetë kanunit — u hodh një tjetër.

— Mat me dy lëvizje — bërtiti Zakua.

Flora heshti. Skuadra qeshi nga dorëzimi i Florës.

Kaluan dy ditë. Xha Frrroku s'po dukej. Filloi të ndihej mungesa e tij në skuadrën tonë. Ne u mësuam me të. Kishte kaluar mbi një muaj që që varur nga kulla e tij dhe punonte çdo ditë me ne. Punonte sa mundte. Ai u gëzua shumë kur skuadra jonë mori flamurin e aksionit. Flamurin e vumë majë një shkëmbi. Më kujtohet që Xhevahiri shkroi për ne në «Zërin e Rinisë», një skicë të bukur me titullin: «Flamuri u betonua në skuadrën e Nasit». Ai shkruante atje edhe për xha Frrrokun. Ne ja lexuam xha Frrrokut dhe ai tha me kënaqësi të çuditshme: «Ju



qoftë, burra, flamurin nuk do ta lamë!»

Çdo ditë që shkonte më tepër i shtohesh besimi xha Frrokut për xhadenë. Në fillim ai u duk ashtu kot në xhadenë tonë, por nuk i besohej të shembe-shin gjithë ato masive shkëmbenjsh. Ai çuditej me punën dhe sigurinë tonë. Ne që ditën e parë të aksionit shikonim skoda që vraponin në xhade, pasagjerë që hipnin e zbrisnin. . . Dhe ja tani xha Froku ishte larguar papritur nga ne.

«Mos e kemi fyer gjë?» Ç'është e vërteta, shoqet tona e ngacmonin pak si tepër. Ai shpesh nuk u përgjigjej fare. Dukej sikur e lodhnin bisedat me vajzat. Ai fliste shumë për luftëra, për ndjekje dhe zinte në gojë shpesh fjalën «shqau».

Kur e kuptoi që shoku ynë, Nasi, dashurohej me aksionistën Eli, ai filloi të mos u fliste. Bile filloi t'i urrente. Në afrimin e tyre xha Frroku shikonte gjëra të «mrapshta». Nasin dhe Elin ne i quajtëm «çifti çapkën». Kishte raste që ata qëndronin në mes të xhadesë dhe bisedonin. Nasi mbante të dyja duart e tij në qafën eELIT. Kjo gjë xha Frroku e tmerronte. Ai as që guxonte t'i shikonte. Edhe kur u dilte përpara ndonjë shkëmb i vogël, çifti çapkën e shtynte bashkë. Xha Frroku ulte sytë.

«Si s'ka turp kjo çikë», mendonte xha Frroku, «prindërit e kanë dërgue në aksion, e kjo. . . Si nuk i flasin pak shokët!?»

— A të pëlqen nusja ime, xha Frrok — i tha një ditë Nasi. Xha Frroku uli sytë. Edhe Eli kishte ulur sytë.

— Nga je ti — i tha xha Frroku.

— Nga Korça.

— Po ajo?

— Nga Himara.



— A e dinë prindërit e saj?

— Jo, akoma. Kur të mbarojmë aksionin, do të shkojmë të dy në Himarë dhe...

Xha Frroku tundi kryet dhe mbi vetullat e bardha ju thelluan ca rrudha.

«S'e ke mirë, moj çikë, jooo... A ke babë ti? Po mos me dashtë ai?!»



Ne e pritëm xha Frrokun por ai nuk erdhi as ditën e tretë, as të katërtën. Ku ta dinim ne se në kullën e tij kishte shkuar përsëri malësori Pal.

Ai kishte hyrë përsëri si hije kur po binte muzgu.

— Ata duen me na i prishë edhe çikat tona, or Frrok!

— Pse, Pal?

— Kam ndigjue se çikat e tyne janë shpërnda në fshat. E ku dreqin dihet çka kërkojnë ato?! Në një kullë kishin kërkuë teshat e brendshme të grave. Te Uk Haxhija ishin grind. Ato donin çikat tona, me i nxjerrë në mes të fshatit për valle e për kangë... Ata duen me na i prishë zakonet... Me na da krushqitë, Frrok. Ku asht pa kjo?

«E, or Pal Cama, kështu ke fol ti, gjithmonë pas shpine», mendonte xha Frroku. «Ke dredhue, Pal Cama, ke dredhue. Ke qejf me i nxit ti, or Pal, të tana gjanat».

— Dy djem prej atyne deshën me turpnue çikën e Gjergj Kolës. A e ke marrë vesh?

— Jo, Pal, nuk asht ashtu.

— E din gjithë katundi, Frrok. Gjergj Kola u



takue me të parin e aksionit dhe thonë se don me i hedh në gjyq.

Frrokut ju kujtua mirë ajo histori që e kishte dëgjuar në skuadrën tonë dhe filloi t'ja tregonte Palit:

«Dy studentë kishin takue në mes të rrugës Martën e Gjergj Kolës.

— A je e fejuar Marta?

Ajo në fillim nuk ishte përgjegjun, por pastaj kishte shtue:

— A nuk i shifni çorapet?

Pastaj u kishte tregue historinë e fejesës së saj. Ajo ishte fejuë që në moshën shtatë vjeçe.

Nga ngjyrat e çorapeve ato dalloheshin në ishin vajza të fejueme apo të martueme. Pastaj njani nga studentët shkroi një skeç të përfaqshëm me këtë ndodhi dhe e shfaqën në fshat. Babai i vajzës të cilit, siç dukej ja kishte thënë ajo, e kuptoi dhe u revoltua. Skeçi përfundonte me grindjen e vajzës me të atin. Ajo donte të ndahej nga i fejuemi që s'e njipte.

Pas shfaqjes Gjergj Kola kërkoi komandantin e aksionit. Komandanti ynë e mori në çadrën e tij dhe atje ndenji dy orë. Gjergj Kola kishte mbetur shumë i kënaqun nga pritja dhe në fund kishte ngritur dolli për partinë.

— Kjo asht e vërteta Pal.

Malësori Pal kishte dalë duke dredhuar si hije e zezë nëpër natë.

Ditën e pestë xha Frroku ishte ngritur herët. Kishte qëndruar te praku i kullës dhe shikonte si

shuheshin yjet një nga një. Pastaj ishte varur poshtë në drejtim të xhadesë. Kërkoj vendin e skuadrës sonë po nuk e gjeti. «Sa paskan punue këto ditë! Bravo u qoftë, për besë, bravo u qoftë!» Dhe i hodhi një shikim xhadesë. Ajo fillonte tutje pas një mali. Si ishte bërë gjithë ajo rrugë për një muaj?!

«A mban mend, o Frrok», i tha vetes, «kur shkoje për krypë? Baje katër ditë udhë deri në Shkodër. Katër ditë për dhjetë kile krypë»!

Pastaj ju duk se përpara tij ndaloi një maqinë. Ju duk se dëgjoji zërin e shoferit:

— Ku po shkon, xha Frroku?

«A, Pal Cama, Pal Cama!»... — mendoi xha Frroku, «Për besë, or Pal, do t'u them shoferëve mos të të hipin në maqinë se nuk e meriton. Dësh



më ndave nga djemt, or Pal Cama. Po unë të njoft, Pal Cama, të njoft mirë. Thonë mirë që qenin sado ta lashë me sapun, erë qeni do të bjerë».

Xha Frroku na kërkonte. Ai kalonte buzë xhadesë dhe shikonte studentët që punonin me vrull. E pamë nga larg. Ai ishte. Xha Frroku. Ne të gjithë ngritëm veglat përpjetë dhe e përshëndetëm. E takuam të gjithë. Edhe shoqet tona i shtrënguan dorën. Dukej shumë i gëzuar kur mori kazmën.

Na kishte qëlluar një vend i butë dhe ne donim të hidhnim normë. Befas Halilit i mbeti kazma në një kafkë njeriu. Atje ishin një grumbull esh-trash. Nga studimet «arkeologjike» që bëri Kujtimi, aty qenë dy varre të vjetra. Nasi gjeti kafkën tjetër dhe ja afroi Elit në fytyrë. Ajo pati frikë dhe bërtiti. Për çudi të dyja kafkat i kishin dhëmbët krejt të rinj, siç dukej qenë varrosur dy të rinj. Ja treguan xha Frrokut.

— Këtu preheshin dy vëllazën — tha ai.

— Kaq të rinj kanë vdekur?

— Kanë dek nga plumbi ata.

— Si?

— Janë gri me sho-shojnë. Këto male janë gri — tha xha Frroku duke tundur kryet mendueshëm.

— Ç'ngjarje interesante — më tha Flora.

— Hakmarrje — i thashë — ndoshta e zakonshme. Hakmarrja ka qenë kangrenë në këto anë.

Kjo xhade shkon mbi kanune — tha Flora — si të thuash pret kanunet. A nuk të duket sikur xhadeja jonë i nxori rrënjët e kalbura këtij zakoni barbar? Nuk të duket barbar zakoni i hakmarrjes?

— Ai ka kohë që është zhdukur — i thashë unë — para xhadesë.

— E kuptoj — tha Flora — por mua më lindi

idea për diçka të tillë... si të ta them, kjo varet nga trajtimi... Një rrugë që kalon mbi kanune, diçka e tillë.

Megjithëse më pëlqeu një ide e tillë, i thashë:

— Ju poetët i bini shkurt. Kanunet janë si rrënjë, të pleksura me njëra-tjetrën. Ato i gjen kudo. Ja, më thuaj ku fillon kanuni dhe ku rruga jote?

Pastaj ajo mori një rënë kafkë në dorë dhe po e vështronte.

— Ky mund të ketë qenë simpatik — tha ajo. — Ja, mbi këtë ballë i vareshin flokët. Ja sytë e thelluar me shikimin krenar të malësorit. Ja buzët. Unë do ta kisha dashuruar dhe s'do ta lija të vritej kurrësesi.

Xha Frrokut nuk i pëlqeu loja e Florës.

— Nuk duhet tallë me të dekunit — tha ai hijerëndë.

— Do ta hidhje mjekësinë në hakmarrje — tha Kujtimi duke lënë të kuptohej thumbi i tij. (Flora kishte qenë e fejuar me një student të mjekësisë por kohët e fundit ishin prishur. Ai nuk donte ta linte as në aksion Florën). Përpara syve të saj doli fytyra e të fejuarit.

«Të shkojmë në plazh, Floresha, ç'na duhet aksioni. Atje do të rraskapitemi. Unë e rregullova të mos shkoj, Floreta. Ah, plazhi, plazhi». Sa ju neverit ajo fytyrë.

Dhe ju shfaqën para syve degëzat. «Sa shumë degëza kanunësh! Nuk i ka vetëm këtu, në malësi rrënjët kanuni. I ka dhe në Tiranë. Dhe kudo...»

## QUMSHTI I KUQ

«Këta s'janë në vete. Turp, për sytë e ballit... tallen me mallin e popullit. Katandisen dhinë për faqe të zezë... E lënë tufën me një Jaras. Ç'do të bëjë Jarasi me 500 krerë?»

Fliste me vete Jaras Rudi, çobani i fshatit, ndërsa dielli po zhytej ngadalë pas malit.

«Akoma s'po duken. Pse xhanëm s'çajnë kokën fare? Dhive do t'u bjerë në gji dhe do të sëmuren...»

Përveshi mëngët Jaras Rudi, mori kusinë e madhe dhe ju fut tufës. Currilat e parë të qumshtit «vësht, vësht» kërcitën në kusinë teneqeje dhe dhinë të kthyen kokën nga Jarasi.

«E, s'keni faj ju, moj të uruara, jo, keni 10 ditë që nuk u llagaritet gjiri». «Vësht, vësht, vësht» bënte qumshti.

Dhinë i afroheshin Jarasit, sikur t'i luteshin që t'i milte. Ca e shtynin nga pas me anë të bririt. Ca i fërkoheshin pas kuisë së madhe. Dhe e shikonin Jarasin me ata sytë e xhamtë. Dhe kënaqeshin dhinë tek dëgjonin atë qumshtin e tyre që u dilte nga gjiri «vësht, vësht, vësht».

Ca dhive u qe ngjeshur gjiri dhe nuk qëndronin

t'i milte Jarasi. Ato kishin dhembje. Ndonjë curril qumshti «fësht» ja bënte dhe dilte jashtë kuisë. Jarasi u lodh. Muskujt e duarve ju mpinë. Kusia fryhej nga shkuma e bardhë e qumështit.

«S'keni faj, ju, moj të uruara, jo, ju mbledhin në një shtrungë dhe ju lënë me një Jaras. Ç't'ju bëjë Jarasi? Ju e dini që Jarasi me ju e ka kokën, po ç't'ju bëj vetëm? Ja, m'u mpinë duart. Juve ju dhemb gjiri. Fshati pret të marrë qumësht. Dhe Trifon Rapavica s'e bën qejfin qeder. . .»

Ca dhive u qe prishur gjiri. Tek u shtrydhte gjinë Jarasi, dora i zinte ca puçrra të forta. Dhitë hidhnin kërbishtet përpjetë nga dhembja dhe e shikonin me inat Jarasin.

Kishte pllakosur muzgu. Jarasi u ngrit më këmbë. Mesi i theri nga dhembja. «Eh, more Trifon Rapavica! . .»

Afroi duart te fytyra. «Ouu. . . Gjak, për nder, gjak. . . Dhe populli pret qumësht. . . Qumshti më është bërë me gjak. Po tani? Më mba fjalime nëpër mbledhje shoku Trifon. . . Do të bëjmë këtë e do bëjmë atë e ma lë tufën me një Jaras? Gënjen dhe sekretarin e parë. . .»

«Që nesër, shoku sekretar. Është orientim partie. Ne nuk e bëjmë dy fjalën e partisë. Partia kështu e, partia ashtu e...» — dhe gënjen derrçe Trifon Rapavica! Derrçe, po! Po na ngordhin dhitë, dhe ai i bën telegram komitetit të partisë që brenda një dite nxorrem bagëtinë nga oborret. Si atëhere që gënjeu për tepricat e shtetit. Derrçe gënjen, derrçe, sikur ka nevojë partia për dëngëlat e Trifonit.

«Do bëjmë stalla, shoku sekretar. Bazën ushqimore e kemi afër. Çobanët i kemi. Populli është gati.» — Gënjen Trifoni.



Dhe ma lë tufën me një Jaras. Dhe fshati pret qumësht. Hajde Trifon Rapavica, se do ta gjesh kogen e ullirit. Se t'i di fshati bilahitë, t'i di».

U afrova te kusia me qumësht. Ndezi çakmakun dhe e afroi tek ana e kuisë. Qumshti ju duk i verdhë. Nepër shkumën e qumshtit dukeshin ca vija të kuqërremta. «Gjak, për nder, gjak. Qumshti është me gjak.»

Ju fut prapë tufës që të shihte dhitë e sëmura. Dora i zinte ca puçrra në gji të dhive dhe Jarasi psherëtinte. Qenë ca puçrra të pështira ato. Duke shtrydhur gjinë, puçrrat hapen dhe sëmundja kap të tërë kopenë. Jaras Rudi hapi derën e vathës dhe u bërtiti dhive. Dhitë dolën duke u shtyrë.

«Ikni sot, moj të uruara, ikni! Flini në oborret tuaja! Po ju bëj një lëshim sot. Nesër do shihemi prapë. Ikni sot, se Jarasi ka punë me Trifon Rapavicën. Jaras Rudi nuk është zënë me njeri deri më sot, por sot... se vetëm për llafe je, Trifon. Për dëngëla. Dhe më merr dyzet ditë-punë në muaj. Qyl m'i merr.»

U nis pas vrapit të dhive. Ndërsa dhitë bridhnin nëpër të tatëpjetën e fshatit duke ngritur pluhur.



Salla u mbush plot. Veç komunistëve kishin ardhur nga rinia, nga fronti, kishte mësues dhe ca gra. Sapo hapi mbledhjen sekretari i organizatës bazë të partisë, u ngrit Trifon Rapavica.

«Unë nuk jam dakord ta bëjmë mbledhjen e organizatës së partisë... Këtu ka lloj-lloj njerëz... Që

më 1949, kur u pranova unë në parti, i kam premtuar partisë ruajtjen e konspiracionit. Një. Dhe e dyta kërkohet që Jaras Rudi të mbajë përgjegjësi për ç'kollektivizimin e bagëtive të oborrëve. Jarasi si komunist nuk duhet të përkulej ndaj vështirësive të para. Kështu ai diskrediton. . .

— Mjaft — e ndërpreu një i ri. — Fillove nga konferencat ti. . .

— Ai do të mbulojë ato të tija — tha Jaras Rudi. — Unë nuk trembëm nga vështirësitë. Nesër prapë me dhi do të vete. Sot ta shohim një çikë më shtruar punën e dhive. Dhitë janë të sëmura, shokë. Do na ngordhin dhe do t'i përgjigjemi popullit. Nuk mbahehet tufa me një Jaras. Atyre u kullon gjiri gjak. Populli pret qumësht. Qumshti është bërë me gjak... Për këtë të përgjigjet Trifon Rapavica! Ai, jo unë!

— Ai, ai të përgjigjet — thanë disa të tjerë.

— Të gjejmë dy barinj të tjerë — tha Mitro Vavua. — Të vejë dhe Kosta në qytet të marrë ilaçe dhe ta zgjidhim mirë këtë punë.

— Ti, shoku Mitro, mos i bjerë kaq shkurt — u hodh e tha një mësues — ta zgjidhim vërtet punën, por të gjejmë dhe shkaktarët. Disa gjëra nuk na ecin për faj të ndonjë shoku. Këtu jemi në organizatën e partisë dhe do t'i themi gjërat troç. Kush përgjigjet që s'mori qumsht populli sot?

— Epo ca kanë lopë malteze — tha Rako Isua.

— Ç'do të thuash me atë — ndërhyri Trifoni — ja unë kam lopë malteze. Ju nuk i dini orientimet e partisë. Partia e ka theksuar me të madhe çështjen e lopës.

— Po dhitë dashke që t'i therim që sot, shoku Trifon, prandaj na i ke lënë si mos më keq me një Jaras? Kështu të tha sekretari i parë? Ke lopë ti, po



ma kullot në ledhe të kooperativës.

— Ashtu është, ashtu — thanë pesë, gjashtë zëra bashkë. — Në Tifak e kullot.

— Flisni me radhë — tha sekretari i partisë.

Trifon Rapavica ishte mbledhur i tëri në xhakëtën e meshintë. Kurrë s'e hiqte atë xhakëtë nga trupi. Dukej sikur ajo ja mbulonte të tëra. Të gjitha gjërat tek ai dukeshin të rreme: Edhe kapelja ngjeshur mbi sy, edhe sytë dinakë, edhe koburja nga pas. Por më i rremë dukej zëri i tij. Një zë i hollë si timbër llamarine. Të gjitha punërat i kishte provuar: sekretar organizate, kryetar kooperative dhe tani kryetar i këshillit të fshatit. Tundte supet nëpër fshat dhe i dukej se ai kishte të drejtë të urdhëronte, të vendoste. Mbante fjalime nëpër mbledhje dhe i shtypte nja 40 ditë-punë në muaj.

— Me leje — tha Jaras Rudi. — Unë do të flas

prapë për dhitë. Trifoni i tha sekretarit të parë që ne i kemi gati barinjtë. Pse e gënjeu dhe e la tufën me një Jaras? Pse i bëri telegram komitetit të partisë dhe i gënjeve, Trifon Rapavica? Për këtë do përgjigjesh! Kaq kam. Të mendojmë edhe për stalla kolektive. Edhe për bazën ushqimore. Se nuk mbahej me fjalë e me telegrame bagëtia. Kështu.

«Do ma paguash, Jaras Rudi, mendonte Trifoni, do të ma paguash.

— Mirë e ka Jarasi, shokë — tha Kosta veterineri — bagëtia duan kujdes. Sëmundja e gjirit është ngjitëse. Dhitë duan mjekuar e izoluar. Që këtë muaj të ndërtojmë stallën dhe të mbledhim bazën ushqimore. Trifoni është nxituar që i dërgoi telegram komitetit. Është treguar si të thuash...

— Servil — tha Ylberi.

— Kujt i thua servil ti, more? Unë jam komunist — bërtiti Trifoni. — Që nga 43-shi jam komunist — Unë jam kryetar pushteti.

— Ti, ti i ke bërë të gjitha — ja ktheu Ylberi. — Edhe këmbën me kulpër të egër ti e bërë që të të hapej plaga... Po se s't'i dimë ne kujton ti? Që të mos shkoje më partizan... Nga kulpra që vure. Ti na i bie vërdallë punërat në fshat. Servil je, posi. Qëndron gazi i komitetit, ti fap do t'i vësh një gur' gomës, që të mos bjerë gazi. Vijnë shefat e komitetit, ti fap krahun e në shtëpi. Ja shtron me të ngrëna e me të pira që ta kesh mirë me ta. I dërgove dhe një bidon me mjaltë shefit të arësimit që të të jepte bursë për vajzën. Shoku R, njëherë ta la mishin në hell; se ishte mësuar me të tjerët...

Mbledhja ishte nderur.

— Unë kam një pyetje tjetër — tha xha Sokrati. — Më shumë për organizatën, se organizata e parti-

së është pajtuar me disa gjëra... Pse nuk ndërtohet mulliri me korent? Shteti na i ka dërguar të gjitha. Ç'bën organizata bazë, ç'bën pushteti? Ne harxhojmë dymijë ditë-pune në mullirin me ujë.

— S'kemi teknik — u hodh Trifoni.

— S'është e vërtetë.

— Ti do të vësh djalin tënd në mullirin me korent. Prandaj dhe fshati pret djalin tënd të kthehet nga ushtria. Mos u habit, vetë e ke thënë te Mitro Vavua.

— Të ngrihet Mitrua — thanë ca.

— Ma ka thënë njëherë, shokë, nuk e mohoj — tha ai.

— Do t'i ketë të gjithë njerëzit e tij me ditë fikse! — tha Dhora.

Trifon Rapavica rrinte përballë në presidium i ngrysur, dinak, duke shuar herë pas here me këmbë bishtat e cigareve që hidhte në dysheme.

— E pse jo — tha Jaras Rudi — për vete shtyp 40 ditë-pune qyl. Njëzet ditë i merr si elektrikist. Kot i merr këto. Le që ne kemi caktuar Ladin për këtë punë. Ky u fut me pretekstin se kemi ca festa para, se duhen bërë dezurne e ku di unë ç'thotë... Njëzet ditët e tjera i merr qyl fare. Bën roje në bostan. Roje i thëncin. Kullot lopën nëpër ledhe të kooperativës dhe në bostan lidh qenin. Qeni leh dhe duke lehur i shtyp njëzet ditë-pune në muaj. Mos qeshni, shokë, se punojmë tërë ditën dhe këtu po paguajmë dembelin me ditë-pune.

— T'ja shtrojmë popullit, shokë — thanë ca të rinj.

Njerëzit ishin ngritur më këmbë dhe bënë zhurmë.

— Ta shtrojmë nesër në popull — tha sekretari i organizatës bazë. — Dakord...

## KUJTIME TË NDEZURA

*15 Maj 1944*

Ne zhvilluam luftime në një pyll. Gjermanët nuk e prisnin që ne t'i sulmonim nga të gjitha anët e pyllit. Nga kompania e tretë u vranë dy vetë.

Pranvera është afër. Më duket sikur toka nxjerr lule dhe qielli hedh plumba. Plumbat korrin lulet dhe lulet ngrihen prapë. Baroti djeg barin dhe bari mbin prapë. Trupin e pranverës e shpojnë plagët, dhe ajo i mbulon plagët prapë. Sa predha vërshtë-llyen sot mbi pyll!.. Vende-vende pylli mori flakë, po gjelbërimi po mbulon dhenë...

*25 Maj 1944*

I bëmë një pritë të fortë armikut. Lufta si duket po mbaron. Edhe predhat e armikut duken sikur vërshtëllejnë të lodhura e të trishtuara. Sulmet tona janë të fuqishme edhe vdekjeprurëse. Kudo që shkel brigada jonë, ngrihet flamuri i çlirimit.

*26 Maj 1944*

Sot m'u vra Xhorxhi, shoku im më i ngushtë. Më

erdhi keq për Xhorxhin dhe, kur mbeta vetëm, qava. Ishte nga anët e Korçës ai. U njohëm këtu dhe ishim si vëllezër. Më tregonte gjithnjë historinë se si ja kishte punuar së fejuarës duke i hedhur një gotë ujë në qafë. . .

### 1 Qershor 1944

Më zgjodhën zëvendëskomandant brigade. Më duket akoma e pabesueshme. . . Unë zëvendëskomandant brigade?! . Djali i Kozma Xhindollit që s'e ngopi kurrë barkun me bukë?! E pabesueshme, për nder. . .

### 5 Qershor 1944

U nisa për në shtëpi. Më kishte grirë malli për të gjithë. Aty afër fshatit takova Andonin. U përqaftuam. Ndezëm duhan. Pastaj ai më tha që ishte vrarë Themo Vasi. Unë mbeta në vend si i ngrirë. Qava për Themon. Ishim rritur bashkë. Unë isha pak më i madh se ai. Kur ktheheshim në shtëpi, më dilte nëna e tij përpara. . .

— Ma prure Themon, Pandeli? — më pyeste ajo.

— Ta prura — i thoshia unë.

Ajo më puthte në faqe dhe në darkë të dyve na bënte petulla me gjalpë.

«Po tani ç't'i them unë nënës së Themos? Ajo do më thotë: — Ku ma le Themon?» — Ç't'i them unë? Jo, nuk shkoj në fshat. Vendosa. Pa marrë hakun e Themos nuk kthehem i gjallë në shtëpi». Dhe u ktheva nga rruga.

### 10 Qershor 1944

Sekret: Sot më vajti mendja te Margarita. Një-

herë në shtëpi nëna tha: «Për Pandeliun tim vetëm Margarita bën për nuse.» Unë u skuqta nga turpi dhe ika, por mendja më mbeti atje... Rita, ti i ke gërshetat aq të gjatë... Faqet të kuqe... Këtë e kam akoma sekret, por, kur të kthehem nga lufta, do të të kërkoj.

### 13 Qershor 1944

Brigada jonë mori urdhërin për çlirimin e një qyteti kryesor. Armiku ka shumë forca të blinduara. Këto ditë presim betejën përfundimtare për çlirimin e qytetit. Luftës po i vjen fundi. Gjithë populli është ngritur maleve si stuhi. Nuk është e largët dita...

Ç'do të shkuaj unë ditën e çlirimit në këtë ditë? Të bëj një vjershë? Unë kam qejf të bëhem poet, të thur këngë. Komisari më thotë të bëhem oficer... Nuk është keq dhe oficer, po unë dua të thur këngë... Pse, oficeri nuk thur këngë?!

### 14 Qershor 1944

Hëngrëm bukë buzë një përroi. Përroi zbriste nga mali me gurgullimë. Partizanët këndonin grupe-grupe. Unë kisha ndenjur në një gur në mes të përroit dhe isha si i dehur nga gëzimi. Shkakun nuk e di. Më duket sikur ujërat pranverore të përrenjve, këngët e shokëve më gurgullonin në shpirt. Të gjitha zhurmat e pranverës, përrenjtë që ishin fryrë e gurgullonin, këngët, era pranverore, krismat më ngjajnin si një jehonë e bukur, si zëri i lirisë. Të nesërmen do ta sulmonim armikun në tri drejtime për çlirimin e qytetit.



Lufta u ndez e ashpër në çdo drejtim. Qyteti nuk u muar dot. Armiku kishte forca të shumta. Shumë shokë na u vranë. . . Pashë në ëndërr flamurë, flamurë të kuq m'u ngritën në kujtesë si zjarre të ndezura. Ç'janë këto zjarre që po shpërthejnë kudo? Zjarre, zjarre me flakët në qiej. . .

.....

Këtë datë nuk e shkroi dot. Një plumb e mbajti në vend. Ai mori urdhërin për të marrë kodrat e jugut të qytetit. Një pjesë e brigadës me në krye Pandeli Xhindollin po vërshonte në qytet. Ata zvarriteshin duke luftuar nën breshërinë e armikut. Pandeliu me automatik në dorë, duke qëlluar herë me zvarritje herë me kërcime, doli në një vend dhe për një moment vuri dylbitë në sy. Një plumb e qëllloi në lule të ballit. Ai qëllloi me breshërinë e fundit në drejtim të tyre dhe ra përmbys. Qe një vend pak i sheshtë atje plot me bar e plot me lule. Zëvendëskomandanti i brigadës ra në mes të luleve dhe lulet u lagën nga gjaku i tij. Dora e mbledhur grusht tregonte gjermanët. . . Në xhamet e dylbive të tij lëviznin uniforma të huaja.

Ditarin e tij e gjetën në xhepin e këmishës. Ishte një blok i vogël plotësuar me kalem kopjativ. Ja dorëzuan komisarit të brigadës ditarin dhe komisari një pjesë të tij e lexoi para brigadës. Ishin rreshtuar gjithë brigada dhe gjithë qyteti për të nderuar atë dhe shokët që u vranë atë ditë. Para trupit të tij qëndronin tre ushtarakë pa lëvizur. Pas disa minutash komisari i brigadës doli përpara. Ishte i zver-

dhur në fytyrë. Qëndroi te koka e Pandeliut, u ul pak dhe dukej sikur do t'i thoshte diçka në vesh. Brigada dhe qyteti i çliruar ndiqnin me vëmendje veprimet e komisarit. Pastaj komisar i vuri dorën mbi ballë sikur ta përkëdhelte. Flokët i dilnin nga kapelja ushtarake dhe i lëpinin ballin e gjakosur. Ca flokë të zez si pendë korbi. Komisar i rregulloi flokët me dorë dhe ja hodhi në anë të ballit. Plumbi e kishte marrë në lule të ballit.

— Shokë — tha befaz komisar — lufta na rrëmbeu edhe Pandeliun, zëvendëskomandantin e brigadës. Dje shoku Pandeli, duke sulmuar si luan për çlirimin e këtij qyteti, ra... (këtu komisar i pushoi pak dhe dukej sikur s'kishte fuqi të vazhdonte). — Qyteti u çlirua dhe gjithë Shqipëria nuk do ta harrojë kurrë... Shtabi i brigadës vendosi që t'ja bëjë varrin në majë të shkëmbit.

Kur e ulën në varrin e gurtë, komisar i nderoi me grusht dhe ca breshëri armësh nderuan trupin e tij. Varri i Pandeliut ishte në zemër të shkëmbit. Vunë edhe një pllakë mermeri në atë shkëmb.

Aty nga vitet e para të çlirimit u ngrit fshati ynë dhe tha:

«Mirë është edhe atje Pandeliu, por e kemi ca si larg, na ka marrë malli». Dhe vendosën ta merrnin në fshat.

Shkuan dhe e gjetën atë shkëmbin ku qe varrosur ai. Dymbëdhjetë fshatarë dhe një bashkëpartizan i Pandeliut. Hipën majë shkëmbit. Panë varrin, pllakën e mermertë. E nxorën Pandeliun.

— Do të qe më mirë ta merrnim me gjithë shkëmb — tha nënkryetari i komitetit.

— Vërtet, bukur e kanë vënë mbi këtë shkëmb — tha një tjetër. E morën në dorë Pandeliun. Ai qe

i rëndë. Një synduk i madh me llamarinë të bardhë. Kapakun e kishte të puthitur mirë dhe të pikuar me dyllë të trashë.

Fshatarët qëndruan të heshtur para tij.

— Lëre, mos e hap — tha prerë njëri.

— Kështu ta shpiem — tha nënkryetari. — Mirë është në këtë sënduk.

— E ka porositur komisari i brigadës — tha veterani. — E punuan natën dhe në mëngjes e vumë.

— Bukur e kanë punuar!

E sollën në fshat. Fshati kishte dalë i tëri të prishte Pandeliun.

— E po uleni një çikë de — tha nëna. — Nuk qaj. Mos u frikësoni, por më ka marrë malli... U bënë kaq vjet që s'e kam parë.

E ulën. Njerëzit e rrethuan. Nëna e përkëdhelte me dashuri me të dyja duart. «Të keqen nëna, Pandeli», thosh me vete. Pastaj mbështeti pak ballin në anë të sëndukut dhe ndenji ashtu me duar të hapura për disa minuta.

— Ta mbajmë këtu në mes të fshatit — tha një plak.

— Jo — tha një tjetër — ta shpiem në mes të sheshit të lapidari!

— Mirë është dhe atje — aprovuan të tjerë.

Dhe e varrosëm në mes të sheshit, atje ku mbli-dhet gjithë krahina për të festuar ditën e çlirimit.

## RRAFSHIMI I SINOREVE

Fshatarët po dilnin nga mbledhja të lodhur. Mbi kokat e tyre, jashtë në horizont, dukej një copë qiell mbushur me yje.

Të fundit dolëm unë dhe instruktori i partisë. Jashtë bënte fresk. Frynte një fllad pranveror që na ledhatonte fytyrën. Ta kishte ënda të merrje frymë.

Gjithë qenja të mbushej me aromë që nuk përcaktohej nga ç'lule a nga ç'pemë vinte, vetëm se ajo të dehte.

— Rrimë pak këtu — i thashë instruktorit — është shumë bukur.

— Është vonë — tha ai — ora po vete tre. Pas pak do të agojë.

— Unë nuk mund të fle tani — i thashë. — Shiko ç'aromë, ç'freski!

Zgjata dorën para si për të kapur atë fllad pranveror dhe ndjeva freski nëpër gishta. E ndjeja shumë pranë pranverën. Më dukej se më kishte pushtuar krejt. Era më trazonte flokët.

Fshatarët po largoheshin në grupe duke diskutuar.

Në anë të rrugës na priste një njeri.

— Ai është kryetari — tha instruktori. — E vure re ç'qëndrim mbajti në mbledhje?

— Abstenim — i thashë unë.

— Jo — tha ai — heshtja e tij ka qenë kuptimplote. Ai nuk e ka dashur bashkimin e kooperativave.

— Çudi — thashë unë. — Gjashtë orë mbledhje dhe të mos flasë asnjë fjalë kryetari i kooperativës!?

«Kujdes kryetarin, puno me kryetarin» — e kishte porositur sekretari i parë instruktoria.

— Është organizator i mirë — tha instruktoria — por kokëfortë e konservator. Do t'i shkojë gjithnjë e tija...

— Po të pres të shkojmë nga shtëpia, shoku instruktor — tha kryetari.

— Jo, nuk vijmë — u përgjegj instruktoria.

Heshtje. Kryetari e theu i pari:

— Ja, u bë dhe bashkimi... se e kishit merak...

— Po ti, pse nuk doje? — pyeti instruktoria.

— Kush tha?! Unë...

— Lëri këto, po nuk të dëgjoi fshati këtë radhë...

— E ke gabim, shoku instruktor... Po s'ka gjë... s'ka gjë. Kam 13 vjet që po drejtoj kooperativën. Dhe ja tani na nxirrni dhe kundër orientimeve të partisë... S'ka gjë... s'ka gjë... u mësuam... Të shohim kryetarin e ri tani...

Kryetari u largua pa na përshëndetur.

Ne shkuam në hotel dhe një copë herë biseduam për kryetarin.

— Shkoi shumë vonë — tha instruktoria — të paktën të flinim nja dy orë.

— Unë s'kam gjumë.

Nja tri orë ata folën për grindjet që kishin me fshatin Nival. Edhe emrin ja kishin ndërruar «Rival».

— Interesant — i thashë — gjithë ato grindje, gjithë ato gjyqe për kufitë...

Të duket sikur me luftë dhe me sherre e ka kaluar jetën ky fshat.

— ...

— Të zotët ama, njerëz të zgjuar dhe të vendosur.

— ...

— Vetëm nga historia e atyre gjyqeve mund të gjykosh për psikologjinë e shoqërisë së asaj kohe.

— ...

— Le që mirë the ti, problemi më i vështirë është ai ekonomik, tani për tani ka disa që nuk e shohin perspektivën e kooperativave të zmadhuara...

— ...

— Apo flë, more?

Unë heshta dhe ndjeva frymëmarrjen ritmike të instruktorit. Atë e kishte zënë gjumi.

«Është lodhur, thashë me vete, ju desh të fliste tërë ato orë».

Ndërsa unë sonte nuk kam gjumë. Sonte kam dëshirë të bisedoj me të gjithë fshatarët. Ç'mendon xha Foti?

«Pse të bashkohemi me ata, mor vëlla? Ne marrim më shumë. Ne kemi më shumë bagëti, i kemi arat me ujë. Ata edhe kashtën e lënë të kalbet rrugeve, pastaj në dimër lipin».

— Kështu thoshje dhe kur formuam kooperativën ti — e kishte ndërprerë sekretari i organizatës bazë të partisë.

— Po pemët pse i shkule nga kopshti? — ishte hedhur një i ri.


— Kot.

— Jo. Ti i shkule nga kopshti dhe i vure rreth

shtëpisë se mendove që do të shkurtoheshin kopshtet personale.

— E po, i ka kryer bimës qarkullimin bujqësor — tha mësuesi i biologjisë.

Të gjithë qeshën. Edhe unë qesha. Pastaj zëri i instruktorit mbushte boshllëqet. Ai fliste për traktorë, për farëra të zgjedhura, për sistem ujitjeje... dhe dëgjonin të magjepsur të gjithë fshatarët. Kryetari sonte nuk fle. Ndoshta mendon si mund të bëhet kryetar i kooperativës së bashkuar... «U fshehe pas gishtit, kryetar!»



Pa dashur m'u ngritën në kujtesë kultat e sinorëve. Kultat ndanin sinoret. Ato qenë ca pirqje të larta, të ngritura me gurë të bardhë. Brenda në to fshatarët hidhnin qymyr. Se qymyri nuk prishet. Edhe sot po të kërkosh, i gjen nëpër shpate kultat e sinorëve. — Ato kanë qenë të përjetshme — thoshte xha Foti.

Pse m'u ngritën tani ato kula në kujtesë?!

Ç'janë ato kula të pabindura që lëvizin e shtyhen herë andej e herë këtej duke kafshuar copra sinorësh?!

Pastaj ndonjë varr i vetmuar në mes të sinorëve,  
afër ndonjë kule.

*«M'u te shpella me dy vëra,  
Më tëhu nuk hyn gjilpëra...»*

«Kemi dhe këngë ne, mor vëlla, për sinoret. Se nuk na është puqur kurrë lëngu me thelë me Rivalin, kurrë».

Nuk ta pashë mirë fytyrën, xha Foti. Shtëllungat e duhanit ta mbulonin si copa mjegullash. Ti nuk shikon, xha Foti, ç'bëhet rreth e rrotull, ç'thonë të tjerët për bashkimin... Ty të janë stamposur sinoret në mendje. Ti dëgjon të tjerë zëra:

... «Ja, ja sipër te kreshta e malit, tek ajo shpella me dy vëra ndahet kufiri ynë me atë të «Rivalit». Në ato vërat mërzhonin bagëtitë tona dhe as kokën nuk e kthejnë nga mushaja e «Rivalit».

Që andej kufiri zbret tatëpjetë duke ndjekur kulat e sinorit deri përposh të bërryli i lumit.

Por fshati «Rival» kishte deputet në qeveri. Një stërgjysh i tyre ka qenë karrocier në suitën e Sulltanit në Stamboll. Fisi i tyre kishte njohur të gjitha qeveritë dhe brez pas brez janë zgjedhur deputetë.

Fshatarët e «Rivalit» prisnin dru në pyllin tonë.

Dhe bagëtia e «Rivalit» sikur e dinin që ishin të deputetit dhe kullotnin pa fre në malin tonë. Dhe kulat e sinorit kafshonin tokat duke u shtyrë gjithnjë në portat e fshatit tonë.

Kryepleqësia jonë gjithnjë është grindur me kryepleqësinë e «Rivalit». Shumë kanë shkruar e kanë vulosur por prapë ata kanë shkelur sinoret tona. Ata na kanë quajtur ne «Karadakas», domethënë kokëfortë...



Pastaj u detyruam të venim bekshi me armë për të mbrojtur kulat e sinoreve.

Një ditë bekshiu ynë vrau një lopë dhe ata na hodhën në gjyq.

Ne dërguam në gjyq Ndreko Peçin si avokat, burrin më të mençuar që ka nxjerrë ky fshat.

Ndreko Peçi ishte i zgjuar. Ai e vërtiste muhabenë si ta doje dhe kishte fituar shumë gjyqe. Por këtë radhë nuk i eci. Për një lopë ne paguam dy dhe Ndreko Peçin e futën në burg.

Burrat tanë u tronditën. U mblodhën kokë më kokë dhe paguam që ta lëronim burrin e dëgjuar, Ndreko Peçin.

Ndreko Peçi erdhi dhe burrat e rrethuan.

— Ç'të thanë?

— Ç'u the?

— Më thanë dhe u thashë plot — tha Ndrekoa — por ata dinin më tepër se unë.

— **Çfarë?** — pyetën fshatarët të habitur.

— Ata i thanë policit «mere e fute brenda»... ja këtë unë nuk e dija.

Kështu filloi historia e gjyqeve. Gjyqe pa mbarim për kufitë, gjyqe të padrejta për fshatin tonë...

Kulat e sinoreve gjithnjë lëviznin, afroheshin sikur donin ta mbyllnin fshatin vetëm në oborrin e tij.

Një ditë deputeti ynë i nderuar thirri gjithë fshatarët e «Rivalit» dhe u tha: «Nesër të gjitha pendët e qeve të Rivalit do të çajnë tokat e reja në Kato-meriq... Për këtë do t'ju paguaj mirë... ç'shikon syri juaj janë tokat tuaja, prandaj nesër të gjitha pendët do çajnë atë tokë të pasur atje...»

Dhe fshatarët e «Rivalit» i premtuan krahun e tyre deputetit.

Prapë u mblodhën burrat tanë kokë më kokë atë darkë. Dhe në mes tyre doli ai, Ndreko Peçi. Qëndroi midis tyre me nofulla të kyçura dhe tha:

Sa pendë ka fshati ynë? Ka nja 50 pendë. Ashtu? Bukur fort! Sa burra jemi këtu?.. Jemi nja 30-40. Ashtu... Bukur fort! Dëgjoni, burra... Nata sot është e bukur. Hëna ndriçon.

Që tani të marrim parmendat, qetë, ç'na duhet tjetër dhe në orën 11 do të çajmë Katomeriqin. Kështu do të bëjmë, burra, se përndryshe nesër në mëngjes Katomeriqi ynë bëhet pronë e «Rivalit».

— Dakord jemi — thanë burrat.

— Shumë mirë. Unë me 10 burra do të nisemi që tani të ndajmë arat për çdo familje... dhe ... aty nga ora 11 çdo pendë të fillojë në arën e saj... .

Qielli me gjithë ata yje të ndezura shikonte ata burra me litar nëpër duar që matnin e ndanin arat natën. Dhe hëna buzëqeshte me dinakëri.

— Kjo copë që këtu deri këtu është imja derisa të vdes — tha Ndreko Peçi.

— Kjo jotja.

— Kjo jotja.

— Dhe e gjithë kjo fushë me këto e këto sinore është e jona, e fshatit tonë deri në vdekje.

Litari dridhej në duart e Ndreko Peçit, shtrihej... dhe linte shenjë.

Atje te lisi i madh në krye të arave, Ndreko Peçi mblodhi burrat e u betuan se do t'i mbronin me gjak sinoret e kësaj fushe.

Nata kalonte dhe burrat lëronin lëndinat e tyre. Qetë tërhiqnin me zor plisat e rëndë.

Ndaj të gdhirë u duk karvani i fshatarëve të «Rivalit». Tek afroreshin dukeshin si ushtarët para betejës. Po ata nuk erdhën. Na panë nga larg dhe u

kthyen, u tërhoqën, duke trokitur me ankimet e tyre në derë të deputetit.

Erdhi një kohë heshtjeje. Dukej sikur një farë boshllëku kishte hyrë midis nesh.

Rreth kulave të sinoreve rritej bari. Sinoret nuk lëviznin më. Sherri qe tërhequr. Atë sikur e kishte mbledhur deputeti në grusht. Por ne e dinim se sherri nuk do të qëndronte atje.

Mjafton të hapte dorën deputeti dhe sherri do t'u afrohej sinoreve tona. Dhe sinoret do të lëviznin. Në themelet e tyre do të mbetej pak qymyr, ca barëra të gjata të zverdhura dhe gjurmët e gurëve të rrethuar nga bari.

Ne po bëheshim gati të prashitnim arat. Në Katomeriç misri qe rritur dhe dukej i mbarë. Kur befaz u shfaq tufa e dhenve të «Rivalit».

Sherri po na kanosej, papritur kopeja e tyre u fut nëpër të mbjellat me zrysh. Nga larg nuk dukej misri. Në të lëviznin papushim dhentë që hanin pa mëshirë misrin tonë. Çobani i tyre bënte sehir pas një shpelle. Bekshiu ynë e pa dhe qëlloi kopenë me armë. Dhentë u trembën. Ca dhen mbetën të vrara. Atëhere doli çobani i tyre duke sokëllitur dhe qëlloi bekshiu tonë. Plumbi i tij u ngul në lisin ku mbrohej bekshiu. Pas pak bekshiu ynë vuri në shenjë kokën e çobanit të tyre. Krismë. Çobani u vra. Sherri na qe përplasur me forcë turinjve. Prapë gjyqe... Prapë dënime.

. . . Mos do lëviznin prapë sinoret?

Të nesërmen kishin ardhur shahitët. U var poshtë tek arat edhe Nreko Peçi. Dërgoi deputeti 5 shahitë në vendin e ngjarjes dhe, pasi u kthyen, u mori gishtin ua ngjeu me bojë dhe vulosi një shkresë.

Panë shahitët e tij ca dhen të vrara të shpërndarra nëpër misër.

Gjetën shahitët çobanin e tyre të vrarë nga plumbi.

Nreko Peçi pa atje misrat e ngrëna. Pa alat të bajgosura dhe dhentë e «Rivalit» pastaj shkoi te lisi dhe pa vrimën e plumbit që kishte hedhur çobani i tyre për të vrarë bekshiun tonë. Nxori sojakun nga brezi dhe filloi të kërkonte plumbin që ishte ngulur në lis. E gdhendi me kujdes dhe gjeti një copë metal të vogël si të djegur pa formë. E mori me kujdes dhe e lidhi në shaminë e ballit.

Sytë i kishin ndriçuar, kishte tundur ca herë kokën duke sharë nëpër dhëmbë.

Në bangën e të akuzuarve rrinte bekshiu ynë, «krimineli» siç i drejtohej gjykatësi. Avokat mbrojtës Ndreko Peçi.

Po shërrin nuk largohet. Ligjet dhe nenet kërkonin prapë shërr. Pas çdo neni sikur fshihej gjithnjë një shërr i ri. Ligji që i fortë për ne rjepacakët «që po shqetësonim gjithë «everinë». Ai na rrinte mbi krye si hije ogurzezë.

Kur gjyqi pë mbaronte dhe vrasja e bekshiut që vendosur, u ngrit prapë Ndreko Peçi nga vendi.

— Po të vritet ky — tha ai — le të shkohen gjithë burrat e fshatit në litar.

Heshtje. Gjykatësit shikojnë njëri-tjetrin në sy.

— Bekshiu ynë u mbrojt — tha ai. — Çobani shtiu së pari.

— Jooo! — bërtitën shahitët e deputetit.

Atëhere Ndreko Peçi futi dorën në gjoks dhe nxori shaminë. Afrohet te gjykatësit, e hap shaminë dhe me dy gishta merr atë copë plumbi.

— E shikoni këtë? Ky është plumbi që çobani qëlloi bekshiun tonë. Bekshiu ynë do që vrarë po

të mos qe lisi i madh ku u ngul ky plumb. Këtë copë metal unë e nxora nga zemra e lisit. Po ju e patë vrimën e plumbit në lis? — u tha shahitëve.

... Shahitët përtypën kundërshtimin nëpër dhëmbë.

Sherri qe mbledhur prapë në dorë të deputetit. Dukej sikur po merrte forcë për t'ju vërsulur prapë sinoreve tona. Sherri qe egërsuar dhe pëshpëriste se këtej e tutje do të vendoste plumbi. Sherri qëndroi pezull ca kohë pastaj u shfaq sheshit. Herë-herë fshihte kokën pas ndonjë shpelle, mbështeste faqen pas pushkës dhe qëllonte. Kështu ata vranë pabesisht Ndreko Peçin, atë Ndrekon tonë të mençur e të mirë. Për hakmarrje ne vramë një djalë 20-vjeçar. Prapë na vranë një dhe ne prapë vramë. I kemi mbrojtur sinoret ne, me gjak i kemi mbrojtur. Kanë mbetur shumë varre nëpër sinoret tona. Dhe sinoret gjithnjë afroheshin drejt oborreve tona.



«Ç'm'u ngjitën tani në kujtesë sinoret, gjyqet?!

— Harroi ato zëra, xha Foti, harroi... Harroi sinoret, gjyqet. A nuk të duket që gjykatësi më i drejtë është instruktori i partisë?

«Jo, jo, nuk e mba vendi të bashkohemi me «Rivalin». Ne jemi grirë e jemi prerë me ta gjithë jetën. Tani të shtrohemi në një sofër?»

Pse m'i copëtove mendimet kështu, xha Foti? Sinore! Gjyqe! Grindje! Varre në sinore! Më duket sikur rri e ruan ai Ndreko Peçi me pushkë! Burrë i zgjuar, për nder!

Po ajo shpella me dy vëra, pse nxin atje në mal, sikur ka mbledhur gjithë qymyrin e sinoreve?

Instruktori fle. Hej — ç'gjumë që më ke, instruktor! Të kam zili, për nder.

«Bashkimi i kooperativave në ekonomi të mëdha duhet të kuptohet si «domosdoshmëri».

Mirë e ke ti, instruktor. Kështu do ta trajtoj dhe në shkrim. Nuk kuptohet nga të gjithë kështu. Sa për titullin, e lehtë është... «Duhet të mbartë një pjesë të idesë titulli» — thotë kryeredaktori. Gjithnjë më kanë pëlqyer titujt me kuptim të figurshëm që, edhe pa lexuar, të japin të kuptosh diçka...

Pastaj m'u ngritën në kujtesë traktorë. Ç'hyjnë traktorët këtu?!

Traktorë nëpër kufi. Ata sikur ecin nga të dy kooperativat dhe rreshtohen te sinoret. Pastaj traktorët filluan të lëvizin ca andej, ca këtej, sikur donin të ngatërroheshin. Ata lëviznin me zhurmë duke dhëmbëkosur sinoret. Ca prej tyre me nofullat e hekurta prishin sinoret, nxjerrin varret, rrafshojnë sinoret.

... Ca pendë që gjasin duke tërhequr ca plugje të rënda, të mëdha sa ata vetë.

... Kryeredaktori ç'ka që ankohet! Po ky Nreko Peçi, pse më del përpara duke më ndaluar me kra-hë? «Mos e dërgo atë shkrim jo... jo, prit sa ta vras deputetin!»

... Copa mjegullash si kuaj të bardhë bredhin poshtë e lart nëpër sinoret.

Po ti, xha Foti, e ngrite dorën për bashkim? Nuk të vura re...

Më kishte pllakosur gjumi. Një gjumë i shqetësuar. Jashtë po zbardhte. Frynte një erë e freskët pranverore. Era e gjetheve dhe e luleve që po çelnin...

## MOS E PRISHNI RRESHTIN

Ai hyri rëndë-rëndë në oborrin e shkollës dhe na përshëndeti duke ulur pak kokën.

— Mblidhuni — tha me atë zërin e hollë karakteristik.

Ne ende ishim të shpërndarë. Nëndrejtori na erdhi papritur. Nuk donim që ai të na vinte nga pas në ekskursion. Ne do të na shoqëronte Todi, atë kishim ftuar.

— Mblidhuni, po ju them — bërtiti përsëri. — Ti atje, bjëri ziles!

«Koloneli» u hodh me vrap t'i binte ziles. (Bertin e thërrisnin «Kolonel» se ishte qethur kolonelçe. Ai i mbante flokët pak më të gjatë se të tjerët. Një ditë nëndrejtori ynë i bëri një shkallë me gërshërë në flokë dhe Berti u detyrua të qethej kolonelçe. Veshët i kishte pak të mëdhenj dhe i dukej koka e thatë me veshët si llapush. Mua më kujtohet që atë ditë Berti u zemërua shumë dhe nuk erdhi në mësim).

Berti filloi t'i binte ziles me forcë...

— Ekskursion me zile — më pëshpëriti Neta në vesh.

Ne po afroheshim si me zor afër nëndrejtorit, që na shikonte me inat.

— Rreshtohuni në dy kolona. Paraleli «A» këtu, paraleli «B» këtu — tha ai.

Zilja vazhdonte të binte pa pushim si alarm.

— Mjaft më me atë zile — klithi ai. — Rregullo-  
ni rreshtin! Mbani distancën!

Ne u reshtuam dhe pamë që nëndrejtori ynë u duk si i kënaqur. Qëndruam «gatitu» ne, prandaj u kënaq ai.

Nëndrejtori, Çave Talati, doli në krye të rreshtit, futi dorën e vogël në xhepin e palltos gub dhe nxori një blok të vogël.

Dhe filloi me atë zërin e hollë:

— Për nder të 30-vjetorit të Partisë sonë të dashur, matura e gjimnazit tonë, në bashkëpunim me drejtorinë e shkollës dhe në vargun e madh të aktiviteteve organizojnë sot një ekskursion turistik në malin e N.

— Ne e organizuam vetë — më tha ngadalë një shok.

— Pusho, ti atje, mos folë pa leje — bërtiti ai duke rrotulluar qafën me një lëvizje nervoze. Dhe pastaj shtoi: — Shikoni të silleni mirë dhe të mos bëni zhurmë! Në çdo 30 minuta marshim do të bëjmë 10 minuta pushim. Vini re, do ndahemi në dy kolona...

— Dashka të vika dhe ky? — u dëgjuan zëra nëpër rresht. Një kolonë, paralelin A do ta shoqëroj unë; paralelin B, do ta shoqërojë shoku Teodor... Largësia midis dy kolonave do të jetë rreth 100 m.

Pastaj u duk se humbi radhën e «rregullores» dhe shfletësoi blokun.

Mjekra ju zhyt në shallin e ri tërë push.

— Dëgjoni këtu! Ne do të ecim në njësh kolonë. Largësia e një nxënësi nga tjetri do të jetë 1 m...



Ej, ju atje, lini fjalët, filluat që tani?.. Te shkëmbi do të arrijmë rreth orës 14.

— Me leje, unë mendoj të hapim garë, cila klasë do të arrijë më shpejt.

— Jo, jo lini fjalët, s'ka garë marshimi, ka rregulla. Garë doni ju, po... rrëmujë.

— Unë propozoj të marrim dhe zilen me vete — tha një. Disa nga fundi ja plasën të qeshurit.

— Me leje, unë them të shkojmë deri në majë. S'ka kuptim deri te shkëmbi. Atje dhe pionierët mund të arrijnë.

Por mbi zërat tanë u ngrit zëri i hollë i Çave Talatit:

— I lini fjalët! Ka rregulla marshimi. Lini fjalët po ju them! S'ka si të doni ju! Pse, han u bë shkolla? Dhe mos prishni rreshtin! Mos bëni rrëmujë! Edhe kur të kthehem, do të vijmë në rresht! Se harrova, kur të arrijmë te shkëmbi, do të bashkohemi të dyja kolonat. Pa prishur rreshtin.

— Po për të kënduar, lejohet — tha njëri.

— Lejohet — tha Çave Talati me seriozitet.

— Na zuri dielli — thashë unë — të nisemi tani...

— Prapa kthehu! — dha komandën si ushtarak profesor Todi, — Drejtim majës nisu!

Ne u nisëm, ndërsa nëndrejtori i bëri shënjë Tudit që të qëndronte.

— Teodor, ki kujdes rrugës! Mos prishin rreshtat! Mba qëndrim të rreptë me ta dhe kërko disiplinë të fortë! Ki kujdes, se janë ca tipa anarshistë.

— Mos ki merak — tha Todi — do t'i marr të dyja kolonat dhe në orën 3 jemi këtu.

— Jo, jo, do të vij vetë unë... Se kush e di ç'na ndodh... Janë të rinj këta, more, e kanë mendjen firi-fiu... (dhe vuri gishtin në tëmthat e thinjur)

— Unë them të mos vish, se do të lodhesh.

— Bababá, unë të rri?.. Po sikur të na ndodhë gjë?.. Jo ore, dhe ajo na duhet. Kur të arrijmë te dëbora, mos lejo të zërë njeri dëborë me dorë, se do të prishin rreshtin... Dil në krye të kolonës vetë! Hidhe syrin dhe këtej! Ti të ecësh me hapin tim se dhe unë do të jem në krye të kolonës. Të jemi në një vijë...

Pasi tha këto, ai gromësi fort dhe Todi ndjeu një farë neverie, por nuk e pa të udhës që t'i kundërshtonte. Ai nuk donte të grindej.

Çave Talati me hapa të shpejtë doli në krye të kolonës sonë. Ne zvogëluam hapin sipas hapit të tij.

Rrugës kalonin shumë njerëz, disa prej tyre e përshëndetnin nëndrejtorin tonë me shumë dashamirësi. Edhe ky ua kthente përshëndetjen me shumë mirënjohje duke ulur pak kokën mbi gjoks.

Çave Talati ndjehej i kënaqur që ne ecnim në rresht si në paradë. Atij i bëhej qejfi që na e kishte mbledhur neve, na kishte bërë, siç thotë vetë «zap». Ai nuk e kuptonte që ne rrinim vetë kështu të sforcuar. Disa dhe talleshin duke përplasur hapin me shumë forcë...

Aty nga mezi i kolonës nisi një këngë. Në fillim hollë-hollë pastaj kënga u ngrit e plotë. Diana, shoqja jonë, që këndonte shumë bukur, e ngriti zërin mbi të tjerët.

— Jo atë, ç'janë ato këngë dashurie në mes të pazarit... Këngë partizane, mor, këndon!...

Ajo këngë u përpëliti, u ul, pastaj pushoi fare. Kolona jonë filloi ta përplaste hapin më fort si në paradë. Nëndrejtori u kënaq.

Dolëm nga qyteti dhe ja veshëm shpatit të mallit. Paralel me ne që dhe kolona tjetër. Vumë re që

ata nuk ecnin në kolonë si ne por ecnin të lirë. Atje qe dhe profesori ynë i fiskulturës, Todi. Bisedonin ata për letërsinë, për sportin, për festivalin e fundit në radio. . .

— Ata kanë prishur rreshtin — tha një djalë me zë të fortë dhe më shkeli syrin mua.

Nëndrejtori u prish në fytyrë. Në fillim nuk foli pastaj na porisiti prapë që ne të mos i prishnim rreshtat. Shikonte ata të kolonës tjetër dhe lëvizte atë qafën e hollë në jakat e mëdha të palltos.

Kolona jonë ecte me hapin e tij. E mbërthyer dhe e heshtur. Na dukej sikur nuk merrnim frymë li-  
risht. . . Sikur na shtrëngonin rrobet që kishim ve-  
shur.

Unë kisha mbetur e fundit. Nuk ecja dot me hap. Ecja ngadalë dhe mendohesha. Ai doli pak në anë të rreshtit dhe më pa si me inat.

Pas pak nëndrejtori pa orën dhe tha: — «pushim».

— Ta bëjmë në borë pushimin. . . Atje është bu-  
kur. Kolona tjetër ka arritur.

Ai nuk foli. Ne vazhduam. Ai ishte nxehur me profesor Todin. Ne e kuptonim këtë.

— Mos kapni borë me dorë! Mos qëlloni me topa bore! Do të marrim masa! Do të digjet ndonjë!

Ne shikonim që kolona e Tudit po përleshej me borë. Edhe Todi po luante me ta. Ata qeshnin. Thërrisnin të gëzuar. Njërin e shtrinë në borë. Ç'kënaqësi. . .

«Sa të arrijmë te shkëmbi — mendonte Çave Talati, atje të rregullojmë rreshtat. Todi do të përgjigjet për këtë qëndrim liberal».

Nuk qëndruam te shkëmbi. Atje qëndruan nëndrejtori me Todin.

Dielli shkëlqente. Herë-herë frynte erë. Një erë

e ftohtë mali që e ngrinte pluhurin e borës lart. Fluturat e borës shkëlqenin. Rrezet e diellit thyeshin në këto flutura bore dhe shkëlqenin me lloj-lloj ngjyrash. Ç'bardhësi!.. Ç'dritë!.. Na u fut në shpirt kjo bardhësi, kjo dritë... Ne ngjiteshim lart dhe bora bëhej më e trashë.

Ca nga ne, në një gropë mali, u vumë në rresht si vagona dhe rrëshqitnim. Ca bënin mundje me borë. Ca shtriheshin dhe linin figurat e tyre në borë. Ç'bardhësi!.. Ç'dritë! Në sy, në mendje, në shpirt.

Ndërsa pak më poshtë, te shkëmbi, nëndrejtori i kërkoi Todit emrat e atyre që kishin prishur rregullin. Todi i tha se asnjë nga ne nuk e kishte prishur rregullin. Todi është i ri dhe gjithnjë na ka dëgjuar. Çave Talati e kërcënoi dhe i tha se do të përgjigjej në mbledhje për këtë. Todi e kundërshtoi duke mbrojtur të drejtën tonë, vrullin tonë. Pastaj nëndrejtori ja kërkoi me shkrim këto mendime liberale. Todi u revoltua dhe e la vetëm atje te shkëmbi.

Nëndrejtori ashtu i shkurtër, i prishur në fytyrë, me kokën e vogël zhytur në shall i bie nga pas...

— Ja shikoje rininë tënde... Shikoje se ç'po bëjnë... Ti po ngrihesh kundër drejtorisë... Deri në komitet të partisë do të të shpie...

Todi nuk i foli fare. Vrapoi me atë trup atleti pas nesh. Çave Talati ashtu i shkurtër, lëkundej me vështirësi pas hapave të tij. Ai shante me vete dëborën e mallëkuar dhe këpucët që i shkisnin.

Todi doli në një breg dhe i ra bilbilit fort. Ne u mblodhëm menjëherë afër tij. Pas vinte ai. Dukej si një njollë e zezë në borë.

— Si thoni, do të shkojmë në majë — tha Todi me gjallëri.

— Do të shkojmë — buçitëm njëzëri ne.

Ai arriti. Gulçonte nga lodhja. Shalli i kishte dalë nga qafa dhe i ishte varur në një anë.

— Jo, ju nuk do të vini në majë! Kemi urdhëruar për këtë. Ju po shkelni rregulloret e shkollës. Ndonjëri do të marrë veten më qafë.

Ne ndenjëm të heshtur dhe nuk dinim ç'të bënin. Ai na u afrua pranë.

— Edhe ti Shpresa? Edhe ti, Diana... Edhe ti... Edhe ti, Thanas që je paralajmëruar për përjashtim?

— Edhe unë, edhe unë, edhe unë... — folëm të gjithë.

Dhe u nisëm me këngë partizane.

Çave Talati mbeti në mes të borës. Ç'të bënte? Të vinte me ne? S'e linte sedra. As fuqi kishte. Ne vazhdonim ngjitjen me këngë të forta partizane.

«I dola borxhit. Le ta mbajë ai përgjegjësinë».

Befas rrëshqiti në borë dhe u ngjesh në të. Palltoja e madhe gub la ca vija të shtrembra në borë. Ai shau **prapë** këpucët që i shkisinin.

«Si nuk pata fuqi që t'i ktheja? Ah, Todi, Todi, do të ma paguash».

Ai u var poshtë, në ngjiteshim. Pas pak e pamë se si u ul në borë. Dukej nga larg si një çadër e prishur e hedhur pa kujdes.

U ngrit. Në dëborë pa ato vijat e shtrembra që linte trupi i tij dhe paltoja gub.

«Do të më shohësh kush jam, Teodor Vlashi. Ai përjashtim. Ai përjashtim. Ajo një notë në sjellje...»  
Ne ngjiteshim.

Dëbora ishte e trashë. Këmbët na fundoseshin, thellë në të. Miliona xixa të bardha e të kaltëra na ndriçonin në sy, në shpirt.

Dhe u ul në një vend Çave Talati.

«Do t'i përvëlloj ca... Po se na u bë më i rëndë bishti se sqepari...»

Këtu bëka shumë ftohtë. Era të pret fytyrën.»

Ai pa kolonën tonë që ngjitej. Pastaj mendoi për Todin. Për... atë grumbullin me vija të shtrembra që linte palloja e tij në dëborë.

«Tani duhet të mendoj për mbledhjen e këshillit pedagogjik... Që nesër do ta bëj. Cilin do të kem kundër. Zojën, Vangjelin, Manolin... Todin. U bëkan shumë... Po nxënësit? Nuk i thërrasim fare. Ç'duan nxënësit në mbledhjen tonë? Për këtë s'jam dakord... Sa ftohtë që bën... Po dridhem. Këmbët i kam akull... Po sikur të kisha vajtur me ta?..»

Ah, mor Todi, Todi, i vjen rrotull Liljanës ti. Po ç'të të bëj? Të kisha një fakt... Ta shikoje si fluturoje pastaj. Të nisem dhe unë», tha. Këpucët i shkisinin dhe ai ecte ngadalë sikur shkelte zbatshur mbi xham. «Më duhet rreth një orë sa të zbres poshtë. Sa shpejt arritën ata...»

Ai shau dëborën. Shau këpucët që i shkisinin. Shau diellin që nuk qe i fortë. Shau pallton gub.

Dhe dukej ashtu tek zbriste ngadalë-ngadalë si një çadër e hapur përgjysmë me tela të rënë.

## URDHËRA PAS BREGUT

Shoku Zydi mori telegramin, e hapi me shpejtësi dhe tha me vete: «Punë e lehtë kjo».

Befas i shkrepri në mendje që të tregohej më operativ. «Pse, ç'të keqe ka sikur të vriten të tërë qentë? Hiç. Qen janë. Kështu do t'i japim edhe një përgjegje më të plotë rrethit. Dhe rrethi do të na e vlerësojë punën.»

E lexoi telegramin prapë:

«Të vriten gjithë qentë rrugaçë. Janë vërejtur shënja tërbimi, pikë».

«Kështu do të bëhet, mendoi shoku Zydi, kështu, duhet të tregohem më energjik dhe operativ se këto kompetencat e reja kanë pesëqind yçkëla. Unë jam kryetar lokaliteti këtu dhe kundërshtime s'ka.»

Këshilli popullor i fshatit vrau ca qen rrugaçë. Por shoku Zydi i kishte thënë atij që të vriteshin të tërë dhe se atje urdhëronte ai. Një shok i këshillit popullor e kundërshtoi. Me te nxehur që bën shoku Zydi. Edhe pa një pa dy na përpilon një listë të gjatë me të gjithë emrat e qenve të fshatit. Mori lapsin e kuq dhe u bëri nga një kryq. Qentë që kishin kryq do të vriteshin. Shpëtuan pa kryqin e kuq

vetëm tre qen: Qeni i shokut Leko, që është sekretar i organizatës bazë të partisë, qeni i shokut Fane që ka qenë drejtor shkolle dhe i kishte firmosur deftesën e klasës së VI, dhe qeni i Miço Sherrxhiut. Të tjerët duhet të vriteshin dhe pikë. Urdhëri ishte i prerë.

Sekretari i këshillit të fshatit, një djalë kaçurrele verdhë ja tha copë shokut Zydi se nuk ishte e drejtë të vriteshin të gjithë qentë e fshatit.

Më t'i përvishet pastaj shoku Zydi dhe e bën për një lek: «Kështu i kupton kompetencat e reja ti. Ore, ti zvarrit punët e pushtetit. Ore, nuk ke shpirt krijues. Ore, nuk je operativ. Ore...», e ku di unë ç'nxori ajo gojë me dhëmbë të porsavenë.

Por sekretari i këshillit gjakftohtë nga natyra, ja preu:

— Telegrami nga rrethi thotë për qentë rrugaçë.

— Pse ore, ... Ore... ç'të të them, ore... ku ka qen që të mos jetë rrugaç, apo, bredhin në qytyna qentë e këtij fshati?!

— Nuk i vras!

— Do t'i vraç se s'bën!

— Nuk i vras!

— Të urdhëroj unë!

— Vriti vetë — i tha dhe iku i revoltuar.

Kryetarit të lokalitetit i mbeti lista në dorë. I hipën ato të tijat dhe forcoi dhe një herë kryqat e kuq në kokë të qenve. Të nesërmen u dëgjuan 3-4 të shtëna çifteje. E kishin pësuar tre qen. Bile njërin e vrau vetë shoku Zydi duke marrë shënim nga 10 m. largësi, ku qe lidhur qeni. Qeni ulëriti, u përpëlit, pastaj ngordhi.

— Pse ulëriti ai qen — kishte pyetur Miço Sherrxhiu?



— Po vret shoku Zydi qentë — ja preu një murator.

— Po ç'ka ai me qentë?

— Është kryetar lokaliteti!

— E mor Muço, se ç'janë ca kompetenca të reja për mbrojtjen e shëndetit të popullit — tha muratori — po s'lot ndonjë lor (ai e ngatërronte me dashje «lor» për «rol»).

— Ishallah vret Lizën time po, për nder. . .

Shoku Zydi për 3 qentë që u vranë i sposto nga lista me një shënjë një formë «V».

Te qeni i katërt i ngeci puna. Ishte konja e një mësuesi pensionist që nuk pranonte ta vriste. Një kone leshtore, trup-vogël, shumë e bukur.

Ish-gjahatari që kishte dërguar shoku Zydi kërciti në portë dhe kërkoi konen.

— Pse? — tha pensionisti.

— Ka urdhëruar shoku Zydi.

— Ç'ka ai me konen time?

— Është urdhër nga lart.

— Jo. . . jo. S'ka mundësi.

— Ka rënë tërbimi, s'di gjë ti?

— Ku ka rënë tërbimi?

— Te qentë e fshatit. Në fillim tërbimi u duk pas tri maleve por erdhi dhe këtu me anë të erës.

Mësuesi pensionist qeshi.

— Pse qesh, ore, mua ma tha vetë shoku Zydi.

Po të zuri ajo sëmundje, larg qoftë, edhe njeriu ulërin dhe të kafshon si qen. . . Pastaj ti duhet ta dish këtë, se ke qenë dhe mësues. . .

— Ha, na — qeshi mësuesi pensionist.

— Gjahtari plak u revoltua dhe i kërkoi konen.

— Ikë ore — i tha ai — se nuk ta jap. Konja ime nuk del kurrë nga oborri.

— Ç't'i them shokut Zydi?

— I thuaj që unë dua ta shoh vendimin me sy.  
«Ç'burokrat, ç'skolastik!» — kishte thënë shoku Zydi. «Zaten mësues ore, dhe mirë... tërë jetën me libra e fletore e ka shkuar».

U ul në tryezë dhe shkroi këtë vendim:

«Me urdhër të komitetit ekzekutiv të rrethit të vriten gjithë qentë për rrezikshmëri tërbimi».

— Na, kush të mos pranojë jepi këtë vendim.

Ish-gjahtari kishte dhe hallin e tij. Gimi, nipi i tij mbaronte klasën e tetë dhe Zydiu i kishte thënë se do t'i rregullonte ndonjë copë bursë. Se, po ta dha fjalën shoku Zydi, ka marrë fund. (Megjithëse në kompetencat e reja bursat i ndante mbledhja e popullit).

Mësuesi pensionist nuk e dha konen dhe kishte thënë që vendimi nuk kishte vlerë se s'kishte as firmë as vulë...

Gjahtarit të vjetër atëhere ju mbush mendja top se ky mësues na ishte një burokrat me brirë, tamam siç tha shoku Zydi.

«Duhet të tregohem më operativ, mendoi shoku Zydi, vendimi nuk po zbatohet. Si duket po futet në kanale burokratike».

Dhe doli fshatit hijerëndë. Zyra mbeti bosh. Atje, në krahun e djathtë të tryezës binin menjëherë në sy ca libra të trashë, lidhur bukur. Qenë veprat e shokut Enver dhe 3 volumet e Kapitalit të Marksit. Në etazherin e dytë komplet gazetata zyrtare dhe plot broshura të tjera me projektligje e vendime.

Këto të fundit shoku Zydi i kishte kaluar disa herë në dorë. Mu mbi tryezë kompetencat e reja të këshillave popullore. Këto e kishin lodhur të ziun Zydi. Ai që mësuar me ato të parat. Shokut Zydi i

pëlqenin ato. Qenë më të sakta. Ai i kishte mësuar thujtë përmendsh sikur t'i kishte shpikur vetë. Këto të rejtat, mor vëlla, të mira janë, po... S'merr dot një vendim, se duhet të pyesësh gjithë miletin.

Le pastaj, po sikur s'mbahen as mend mirë. Ka 28 vjet shoku Zydi në punërat e pushtetit dhe i njeh me rrënjë e dhëmballë.

Vetëm dy herë në jetën e tij ka ndjerë pak të mardhur.

Një herë kur e detyruan të mbaronte shtatëvjeçaren...

Po e mori, ama... Herën e dytë e caktuan kryetar kooperative. Atje e pa keq. Por shyqyr që vetëm një vit e mbajtën. Dhe zuri këtë karrige që shikoni. I ka vënë dhe një jastëk të hollë karriges se, helbete, të qëndrosh 28 vjet në vend ka pasoja trupi...

Në format e edukimit në organizatën bazë të partisë Zydiu ishte nga të parët që diskutonte. Por ka autoritet ama, helbete, kryetar lokaliteti.

Për babaxhan, ama, është babaxhan. Nuk të bën kurrë keq. Vetëm se duhet të kesh pak kujdes kur bisedon me shokun Zydi. Të mos e kundërshtosh. E po, mos e kundërshtoj, mor vëlla. Ç'të duhet, kur s'të bën as mirë as keq?!

Po ta kundërshtosh ai do të ta zërë shtegun. Një shteg e ka zënë po të shikojmë ç'krismë do të bëjë.

Ishte puna për një fejtון të botuar në gazetën lokale. Fejttonin e kishte shkruar një mami, një shejtankë e tërë. Bile me emër e me mbiemër për shokun Zydi:

Na ishin ngatërruar dy dele këtu e nja tre vjet të shkuar. Gabimisht kishin hyrë në qilar të njëra-tjetrës. Njëra ishte bejkë, tjetra syskë. Fshatari që kish dele syskë donte sysken. Po hajd ta gjeje Sys-

ken dhe bejkën. Ndërhyri këshilli popullor, s'u bë gjë. E mori në dorë për ta zgjidhur personalisht shoku Zydi. Bamb mbledhje shoku Zydi, për t'ua mbledhur këshilltarëve. Bamb kritika. Bamb urdhëra. Bamb në shtëpitë e bejkës dhe të syskës. Bamb mbledhje prapë. Bamb andej e bamb këtej sa u bë një breshëri mbledhjesh derisa shkoi problemi edhe në rreth. Por atëhere kishte ardhur behari, delet kishin pjellë dhe qenë ngatërruar dhe qengjat.

E kishte lexuar shoku Zydi fejttonin, kishte kafshuar buzën me nervozizëm dhe kishte thënë:

«Do të më shikojë se kush jam».

Dhe kishte zënë shtegun që, kur të caktohej kuadri, ta sikterriste nga mëhalla e tejme. Puna e deleve kishte mbaruar me një të mardhur të lehtë, por ç'dreqin e hodhi me qentë?

Andej nga komiteti ekzekutiv i rrethit për shokun Zydi kishin përshtypje të mira. Se me detyrën ishte në rregull shoku Zydi. Ai ja dërgonte informacionet rrethit me përpikmëri të madhe. Bile përpara të gjithë këshilltarëve të tjerë.

Edhe për telegramin për punë të qenve Zydiu do të dërgonte përgjigje që urdhëri ishte zbatuar, megjithëse telegrami nuk kërkonte përgjigje.

«Duhet të jesh korrekt me detyrën», këtë e kishte vath në vesh Zydiu. Thirri përsëri atë ish-gjaktarin e vjetër dhe i dha urdhëra të prerë. Shoku Zydi e kritikoi atë për pazotësi për të vrarë një qen. «Bobo», tha gjahtari me vete, iku bursi i Ladit».

— E kam qen gjahu — tha Miçi — pse ta vras?

— Ka urdhëruar shoku Zydi.

— Po unë e mbaj lidhur, mor jahu...

— Këtë e di shoku Zydi.

U duk sikur u largua gjahtari plak, por ai mori

kthesën rreth oborrit, gjeti kotecin e qenit dhe ja mati në lule të ballit.

E shkreta Rozë, që kish kapur gjithë ata lepuj, ra pa frymë. Kishte ndjerë një krismë të mbytur shoku Zydi dhe spontoi i gëzuar dhe një qen nga lista.

I revoltuar Miçi shkoi në të tëra zyrat që ka fshati. Sekretari i partisë së zonës i tha që ato ishin punëra të pushtetit. Shkoi në zyrë të Zydiut dhe u përlesh me të. Ai i kishte thënë se paraqisnin rrezikshmëri tërbimi prandaj, për mbrojtjen e shëndetit të popullit. . .

Miçi drejtohet në gjykatën e fshatit dhe hap gjyq. Prokurori i fshatit kërkoi të tëra kodet por nuk gjeti asgjë. Në Kodin e Republikës Popullore të Shqipërisë nuk kishte asnjë nen të tillë për qen dhe për shkaktarët e vrasjes së qenve.

U ngatërrua lëmshi.

Prokurori i fshatit i ra telefonit dhe pyeti në gjykatën e rrethit.

Andej i thanë që nuk ishte e drejtë të vriteshin të tërë qentë e fshatit. . .

Atë natë shoku Zydi pa një ëndërr të keqe. Sikur ishte në një pyll të madh e e kishte vënë një qen i bardhë përpara. Vrap Zydiu. Vrap qeni. Qeni donte ta kafshonte, dhe Zydiu nuk vraponte dot. Befas ai ju hodh pas shpine dhe i mori nga xhepi i pasmë i pantallonave librin e kompetencave të reja të këshillave popullore. Dhe ishte trembur shumë.

Në mëngjez kur shkoi në punë, (Ai ishte shembull përpikmërie në respektimin e orarit) lexoi një fletërrufe që i ra si bombë. Fletërrufeja i drejtohej atij personalisht. . . «Ah, endrra, endrra!» — Syri i shkoi te firma. Mamia. Ajo ja kishte qëndisur

«Me urdhërin tuaj, shoku Zydi, janë vrarë ca qen  
që kanë pasë shënja tërbimi. Kufomat e qenve kanë  
filluar të bien erë dhe paraqesin rrezikshmëri kole-  
re. Merrni masa!

*Mamia e fshatit*

## «QILLOTAT ME PLAGË»

Bëhej festë. Grumbulli i madh i njerëzve dëgjonte nga podiumi. Herë-herë sheshi mbushej me duartrokitje. Njerëzit nuk lëviznin nga vendi. Edhe unë rrija midis turmës dhe dëgjoja me vëmendje folësin që shprehej me zjarr për festën e madhe.

— Pirro, Pirro, — dëgjova nga pas. — Hajde me mua, do të dalim në televizor, hajde! E njoh unë atë operatorin, e kam patur nxënës, hajde. . .

— Lërmë — i thashë.

Anastas Mokra iku pak i prekur. Çante midis turmës i emocionuar për të dalë në televizor. Vetëm Anastas Mokra vinte vërdallë sa andej këtej, në atë drejtim që operatori drejtonte kameran për të xhiruar. Dhe herë buzëqeshte, herë ngrinte grushtin lart ballë për ballë aparatit.

«Të më shikojnë mirë të gjithë ata që më njohin, të gjithë. . . Kush e di si do të dal! Do ta porosis vetë atë patjetër. . .»

Dhe vrap andej vrap këtej nga operatori drejtonte kameran. Kur sheshi gjëmonte nga duartrokitjet, në moment qëndronte dhe Anastas Mokra dhe përplaste duart. . .

«Kemi dhe kushëririn e Emililit atje në Tiranë»,

mendonte Anastasi. «Do t'i shkruaj dhe atij që këtë film ta lajë mirë dhe të ma dërgojë të gjithë. Do t'u dërgoj të gjithë shokëve nga një pozë...»

Kur operatori drejtonte kameran nga podiumi, Anastasi e kishte më vështirë. I vinte zor të afrohej nga ajo anë... Megjithëse ishte i sigurtë se edhe andej kishte nja dy poza. Mandej nga krahu i sekretarit të parë i përkulur pak dhe me një buzëqeshje të ëmbël në fytyrë.

«Po të kem dalë mirë në ndonjërin nga ato poza, ... do ta zmadhoj dhe do të shkruaj: Kujtim me shokun R... nga festa e dritave...»

Ka qenë nja njëzet vjet mësues Anastas Mokra. Jepte në shkollë çdo lëndë që t'i thoshje, megjithëse nuk kishte mbaruar ndonjë shkollë të profilit pedagogjik. Nëpër mbledhje diskutonte gjithnjë i pari dhe i jepte rëndësi edukimit fizik dhe kalitjes, ekskursioneve. E ka zakon ai, nuk rri dot pa folur. Po të mos e njohësh, ai fillon nga muhabetet dhe s'mbaron kurrë. Po të mos e ndërpresësh, ai vazhdon të të tregojë për kontributin e tij në kohën e luftës, për konfliktet që ka me baxhanakun, për luftën në Vietnam, për derrin e mirë që ka sivjet për pasterma, për byrekun e shijshëm që i kishte bërë gruaja mbrëmë etj. etj. Pa le kur fillon të të tregojë për aktivitetin e shtëpisë së pionierit në qytet... Se ka merita dhe ka qenë drejtori i parë i shtëpisë së pionierit dhe ka shërbyer në kampin e pionierëve pesë vjet si përgjegjës. Disa nga kampionët e Anastasit tani janë me pozitë. Ata ai i njeh mirë. Disave u shkruan dhe letra. Dhe e fillon kështu: «Më mbani mend? Jam Anastasi, ish-përgjegjësi i kampit të pionierëve në L.»

Se ka dhe halle Anastasi... Ja vajzën e madhe e



ka në universitet po nuk mëson mirë... Interesohet atëhere Anastasi dhe mëson me kënaqësi se vëllain e një pedagogu e ka pasur në kampin e pionierëve. Atëhere ulet dhe i qëndis një letër vëllait të pedagogut. I bën hyrjen e zakonshme, pastaj me marifet rrotull e rrotull i lutet që t'i thotë të vëllait ta ketë pak kujdes vajzën e Anastasit. Në fund: Pres përgjigje. Përfaqime. Me respekt. Anastasi.

Priti po asnjë përgjigje. Atëhere mori rrugën dhe u nis vetë në Tiranë. I thanë se pedagogu kishte leksion, Priti. Dhe vendosi ta kapte në rrugë.

— Profesor, profesor... — I foli nga pas.

— ...

— Profesor, jam Anastasi.

Pedagogu qëndroi në mes të rrugës i habitur.

— Profesor... ndoshta ju ka folur vëllai juaj për mua... I kam dërguar një letër... Kam një vajzë me ju që nuk para mëson aq mirë...

— Nuk më kujtohet... Si e quajnë?

— Villasova Mokra? — tha ai i gëzuar.

— E njoh — tha pedagogu — por s'ka gjë me mua.

— Ashtu? Të më falni që...

— S'ka gjë!... — Dhe iku duke mbledhur supet.

Anastasi mbeti në mes të rrugës. Në moment mendoj dhe u bë pishman pse s'i tha pedagogut që të ndërhynte te të tjerët se Anastasi kishte ardhur që nga larg për këtë punë.

U grind dhe me vajzën për këtë punë. Ajo i tha se i vinte turp t'i dilte pedagogut në sy. Vajza dukej e fyer nga veprimi i të atit.

— Unë s'kam nevojë për ndihmë — i tha ajo.

— Unë kaloj vetë. Oh, sa turp...

— Folë ti, folë, se je axhami, moj e shkretë! Du-

hen zënë shtigjet sot... Po mbete ti në klasë, hallet kërcasin në kurriz të Caces.

— S'kam nevojë, baba, e kupton?

Po s've mend Anastasi.

Shkruaj letra andej, shkruaj këtej, arriti që të mblidhte nja pesë deklarata në të cilat shkruhej se shoku Anastas Mokra kishte marrë pjesë në Luftën n.çl., megjithëse ata nuk e mbanin mend mirë. I futi në xhep deklaratat dhe siguroi njëmijëlekshin plus rrogës kur të dilte në pension...

Një herë kishte ardhur një ministër në fshat për të inauguruar një spital të ri. Na e zë ministrin nga krahu dhe ja do vish nga shkolla ja s'ka.

Deshi s'deshi ministri shkoi në shkollë.

— Ja kjo është klasa e pestë, kjo... Këtu ka mësuar dëshmori K.V..

Ministri rrinte serioz...

— Këto i kam mblëdhur unë, këto unë... Se duhen, shoku ministër, duhen...

Ç'të shikonte ministri? Të gjitha faqet e murit qenë mbushur plot e përplot me fotografi, tablo, copa gazetash.

— Duhet këto, shoku ministër, duhen. Konkretizimi është parim bazë i pedagogjisë...

E futi në sallën e mësuesve. Për çudinë e Anastasit ministri ngrysi vetullat.

Cacja e pa dhe tha me vete: Ç'deshe, o katran, që e more ministrin në shkollë?»

Të gjitha faqet e murit në sallën e mësuesve qenë mbushur me fletë nderi e me fletë lavdërimi. Ca i kishte dhënë seksioni i arësimit, ca këshilli i frontit, ca rinia, ca fiskultura e sporti, ca këshilli i fshatit... E kishte merak Anastasi këtë punë. Nuk i

humbiste kurrë fletë-lavdërimet dhe donte ta shikonte shkollën të bukur «kukull».

— I kam mbledhur për vite me radhë, shoku ministër — foli Anastasi.

— Ç'janë këto, more — foli më në fund ministri — ma keni bërë shkollën si kishë. Hiqni more, të gjitha, ç'ju duhen? Hiqni, hiqni dhe lyni muret me gëlqere... Të zbardhin muret se i keni marrë frymën shkollës... Dhe kishte dalë nga dera duke e lënë të shkretin Anastas me dorën lart, tek tregonte një fletë nderi dhënë atij në vitin 1950 si aktivist i këshillit të frontit.

Anastasi, që ka një nuhatje të mprehtë, e kuptoi se në arësim s'e kishte shumë të gjatë dhe vinte rrotull të gjente një punë pa kokëçarje...

«Sa të dal në pension keq e kam... Mua më duhet një punë e përshtatshme. Duhet biseduar njëherë me shokun Lefter... Ai do të më ndihmojë...»

Më vonë mësoi me kënaqësi se në muzenë e fshatit të tij, si qendër e lokalitetit, do të caktohej një njeri me rrogë... E rregulloi Anastasi, kërkoi çelësat dhe tani, ka nja dy vjet që punon si ciceron.

Ti shkon për të parë muzeun dhe ai të pret me atë buzëqeshjen e gjerë sa një çarçaf.

Muzeumi është i pasur dhe i bukur. Ka qenë shesh lufte ky fshat. Partizanët, mijëra partizanë nga çdo vend, mbushin stendat e xhamta dhe duken ca të vërenjtur, ca buzëgaz, por të tërë krenarë e të vendosur.

Ja në një stendë të madhe 40 dëshmorët e krahinës. Në mes tyre dy heronjtë e popullit.

«Këtë e kam njohur në Kurvelesh, këtë në Pogradec... Ky na erdhi kur krijuam Këshillin N.Ç.1...»

Kjo shoqja që e deleguar kur krijuam organizatën e bashkimit të rinisë... Unë e kam pritur, më kujtohet porsì sot...»

Më tutje në një stendë të madhe një fotografi me qindra partizanë. «Ja, ja këtu në cep kam qenë dhe unë, thotë Anastasi, por nuk njihem mirë. S'më ka marrë mirë fotografia...»

Këtu është spitali partizan. Ja ky këtu është sho-ku K.P., i plagosur. Ka qenë i plagosur rëndë. Më kujtohet që nuk hante fare. Mua më dërgonte nëna darkë më darkë mish pule dhe ja jepja atij. Ai mi-shi sikur e shëroi... Deri më 1952 kam pasur ko-rrespondencë me shokun K.P....»

Më të djathtë të hyrjes, në një dollap të bukur, ishin ekspozuar armë të përdorura gjatë luftës, ma-teriale luftarake, një maqinë shkrimi e djegur si dhe sende të tjera. Në katin e parë të dollapit rrinë palo-sur, të lara e të hekurosura një palë qillota ushta-rake...

Një natë të tërë mendoi Anastasi për këto qillota:

«Ç'të keqe do të ketë sikur t'i vëmë këto qillota në muzeum? Kush i njeh këto? Bukur, për nder... Që këtej e tutje këto qillota m'i ka falur dëshmori F.Z.»

— Shikoi mirë këto qillota, thotë ciceroni. Kujti-mi më i mirë që kam unë nga lufta. M'i ka dhënë dëshmori F.Z. në Pogradec. Si sot më kujtohet. Më hodhi dorën në sup e më tha:

«Anastas, këto pantallona i ke copë e çikë». Se kemi vuajtur ne, mor shok, ju s'e njihni luftën». «Na këto qillota se unë kam dy palë».

U rrokëm më qafë dhe që nga ajo ditë s'u pamë më. Ai ra në Mal të Zi... Kurse unë... ja, mendo-hem që t'i shërbej dhe unë kauzës së socializmit...

Venë e ngacmojnë ca atje në muze, por Anastasi nuk çan kokën. Rrogën e merr.

I bije ca më qafë ai djali i Boços, por shakara, kështu pa dëm, për të qeshur. Vete qerratai drejt e te qillotat.

— Kam një mendim — thotë dhe rri serioz — Këtyre qillotave do t'u bëjmë një plagë në kofshë. Natyrisht me të kuqe. Dhe poshtë do të shënojmë:

«Plagë e marrë në operacionin e dimrit, gjatë luftimeve të ashpra të shokut Anastas Mokra në Kurvelesh. . .»

## BARRA E TURPIT

Motra e tyre lindi në Pépel. Në Pepel lindnin ato që dilnin me doç. Motra e tyre e vetme doli me doç dhe e dërguan në Pepel. Pepeli ishte një fshat i largët, i humbur dhe i shkretë ndërtuar në një gropë pas malit. «Vafsh në Pepel» ishte mallëkimi më i rëndë nga anët tona.

«Vafsh në Pepel», domethënë «dalsh me doç».

Nga fshati ynë nuk mbahej mend ndonjë grua të kishte vajtur në Pepel. Pleqtë thoshin se në kohërat e para kishte vajtur një grua e quajtur Fotini. Ajo kishte dalë me doç po nuk u kthye më në fshat.

Ja tani motra e tyre, e katër vëllezërve, që rop-toheshin duke punuar arat e Peçi Haritos, kishte dalë me doç.

Ata, katër vëllezërit, kur dëgjuan që motra e tyre e vetme qe me barrë, donin ta zhduknin, po ndërhyri pleqësia. Bile dhe vetë Peçua, zoti Peço që kishte nën thundër gjithë arat dhe bagëtitë e këtyre anëve kishte thënë se, sipas zakonisht, ajo duhet të shkonte në Pepel.

Atje në Pepel ishte një manastir i vjetër dykatesh. Me dritare të vogla të prishura nga vitet. Dim-

rit erërat fërshëllenin nëpër ato dritare me xhama të thyer. Verës në katin e poshtëm, në një dhomë të madhe veronin ndonjë tufë me shqerra.

Afresket e manastirit ishin të shuara. Në anët e truallit gjeje copra suvaje të rëna nga muret. Në këto copa suvaje qenë vizatuar fytyrat e shenjtorëve.

Në këtë dhomë lindnin ato.

Trarët e nxirë me plot merimanga. Një dritare vështronte shpatullat e malit. Nga trari i madh i mesit varej një zinxhir i hollë. Zinxhiri dridhej e përdridhej nga dhembjet e lindjes.

Po motra nuk e lëshonte zinxhirin. Ajo e kishte përdredhur disa herë në duar. Dhe zinxhiri tundej, dridhej e rënkonte nga dhimbjet e lindjes.



Kishte çaste që motrës i pritëshin forcat. Ajo varej në zinxhirin e hollë dhe priste që t'i dilte shpirti. Por befaz zinxhiri tundej me forcë dhe gulçonte nga dhembjet e fundit. Pastaj një piskamë fëmije. Lot në sytë e nënës. Një rreze drite nga dritarja që vështronte malin... Një copë nga fytyra e Shën Mërisë, rënë nga suvaja e shikonte me ftohtësi.

Motra mbështolli djalin e vockël në përparsen që kishte shtruar përdhe. E ngriti në dorë atë krijesë të vockël, fëmijën e saj të dashur dhe u afrua te dritarja. Ku e gjeti këtë gëzim që papritur i kishte gufuar shpirtin?! Pse e shikonte ashtu Shën Mëria?

Motra po shikonte shpatullën e malit nga dritarja. Atje binin rrezet e diellit dhe vendi dukej çuditërisht i ndriçuar. Asaj i shkanë lot nëpër faqe.

Ndërsa zinxhiri i hollë në mes të dhomës ishte qetësuar dhe varej drejt sikur të mos kishte ndodhur asgjë.



— Folë — i bërtiti për të njëqindtën herë vëllai i madh — folë, me kë e ke?

Motra rrinte kokëvarur duke qarë dhe nuk nxirrte asnjë fjalë nga goja.

— Folë, bushtë, a merr vesh, Me kë e ke?

Dhe ja zuri mjekrën me atë dorën e hekurt duke ja ngritur kokën lart. Asaj ju shkundën nga sytë dy rrëkera të holla lotësh. Pastaj ai e goditi me pëllëmbë dhe ajo ra e pafuqishme në një anë.

Foshnja qante me gulçima sikur do t'i zihej fryma. Sa shumë qante kjo foshnje!

Vetëm vonë në mbrëmje, kur pllakoste muzgu,



vetëm atëhere i jepte të pinte nëna. Ditën nuk guxonte.

T'i jepte gji ditën?! Po sikur ta shihnin të vëllezërit? Të ushqente atë doçin?

Jo, ajo nuk guxonte. Vetëm natën foshnja bëhej e saj.

Nëna e merrte me dhemshuri në gji dhe nuk ngopej duke e parë. Foshnja pinte si e pangopur. Nëna e shikonte, e shikonte, e shikonte dhe herë-herë i vareshin pika loti.

Vëllai i dytë kishte ditë që nuk kishte ardhur në shtëpi. Ai ruante bagëtitë e zotit Peço në mal dhe varej nga mali 2-3 herë në javë për të marrë bukë. Por qëkur ishte kthyer motra nga Pepeli ai nuk vinte në shtëpi. As për bukë. Rrinte atje nëpër stane duke menduar ditë e natë për këtë turp të madh që u kishte bërë motra atyre. Nuk guxonte t'i dilte fshatit në sy. Më mirë rrinte nëpër stane i vetmuar.

Edhe atje, atij i rëndonte turpi në rrobet e trupit, në gjumë, kudo, bile edhe në shikimet e Bulinës që i rrinte afër.

Nga të katër vëllezërit vetëm të voglit i vinte keq për të motrën. Atij i dhimbej edhe foshnja. Nuk e dëgjonte dot kur qante ditën.

— Jepi të pijë, moj, çfarë ka? Ai po vdes — i kishte thënë një ditë.

Motra i kishte dhënë gji dhe fëmija kishte pshuar.

«Ajo ka turp nga ne prandaj nuk i jep të pijë ditën», mendonte vëllai i vogël. «Sa keq! Po si do t'i vejë filli kësaj pune? . .

Vëllai i madh, që e kemi në vend të babait, mendonte se ajo nuk do të kthehej e gjallë nga Pepeli. Kështu që do ta kishte marrë me vete turpin.

I dyti thotë se ajo mund të vrasë vetëm femijën. . . Ajo do të kthehet e turpëruar dhe na ka turpëruar edhe ne, gjithë fisin tonë. Bile edhe fshatin. Vëllai i tretë do ta dijë cili i ka turpëruar dhe ta vrasë me dorën e tij.

«Atë do ta vrasim, ja kthente i madhi, — por puna është që të mos vijë e gjallë ajo. . . »

Atë ditë që motra u nis për në Pepel ne qamë. Qamë të katër. As kur na vdiq e shkreta nënë nuk qamë aq (se babanë unë nuk e kam arritur. Ai ka mbi 20 vjet që ka vdekur).

Ja tani ajo u kthye e gjallë nga Pepeli. Me gjithë femijën. Me gjithë turpin. Kjo u bë tani. U bë. Por ç'dreqin duan këta vëllezërit?! Ç'dreqin duan? Ku ta dish, motra e ka dashur atë. . . Cili do jetë ai? Pse nuk e tregon? Këtë motra duhet ta tregojë. Fundi i fundit le të martohen, le të iki motra tek ai. Po cili do jetë ky?!»

«Kalama», më bërtiti mua vëllai, «kalama. . . atë do ta vrasim si një dhe një që bëjnë dy. . . Mos do të bëjmë dhe dasmë, zotrote?» Ku ta dish, motra mund ta ketë dashur atë. . . Ajo nuk është e vogël. Po, unë 23, motra 19. Ne kurrë nuk kemi biseduar për motrën në shtëpinë tonë. Kurrë. Ndoshta e kemi quajtur të vogël. Por të katër kemi pritur të na vijë shkesi në derë, e atëhere mbase do ta martonim.

Ç'është e vërteta neve na ka vajtur ters. Vëllai i madh po mbushte të dyzetat dhe akoma nuk po martohej. Nuk gjente dhe nuk i jepnin nuse. Të tjerët prisnin që të martohej i madhi.

Askush nuk mendonte për motrën. Vëllai i madh është i egër. Ai nevríkosit dhe gjithnjë shan nëpër shtëpi zotin Peço. Se ai na shtrydh të tërë. . .



Të gjithë e mbanin në gojë, të gjithë e thërrisnin fëmijën «doç», por vetëm motra e tyre e dinte të vërtetën. Ajo nuk e quante «doç» fëmijën e saj. Nuk e quante kështu me këtë emër të neveritshëm pjellën e saj.

Ajo kishte dy vjet që dashurohej me Filipin e Durinjve fqinjë. Filip Duri ruante vreshtat e zotit Petro dhe ishte 20 vjeç.

Edhe Filipi ishte i varfër, por i ndershëm. Ai i kishte thënë motrës së tyre se do martohej me të dhe vetëm varri mund t'i ndante.

Po asnjëri nuk e kishte veten në dorë.

Filipi kishte baba dhe Filipi mund të martohej vetëm me atë që do t'i jepte babai.

Por kjo s'e shqetësonte aq, më shumë e shqetësonte e motra që ishte rreth të tridhjetave dhe kishte mbetur në derë të të atit. Pa ikur vajza nga shtëpia, djali nuk martohej. Ishte turp. Ishte fyerje e madhe për femrën, domethënë ajo do të mbetej tërë jetën në shtëpi se diç do të kishte ndonjë cen.

— Sapo t'i dalë ndonjë vend motrës do të të marr — i thoshte Filipi së dashurës së tij.

— Po sikur të mos martohet fare motra jote?

— Unë do të të marr — ja kthente Filipi — do të të marr gjallë a vdekur, sikur dhe babai dhe motra të mos duan. Po ata vëllezërit e tu ç'thonë për ty?

— Ç'të thonë... Për ata unë jam ende e vogël. Asnjë shkes nuk më ka kërkuar deri tani. Për mua nuk bisedohet kurrë në shtëpi. Vetëm një herë dëgjova vëllanë e mesmë që tha se duhej nxjerrë plehu nga qilari pa pastaj... Unë e kuptova që ata flisnin për mua...

Një ditë të rinjtë u takuan dhe ranë në gji të njëri-tjetrit.

Pastaj kishte ardhur ai emër i neveritshëm Pe-peli.



— Shko në stan — i tha vëllai i madh të voglit.  
— Në darkë vonë të jeni këtu të dy! More vesh, në darkë vonë! Po të mos dojë të vijë, i thuaj që e dua unë.

Binte shi. Një shi i dendur që s'kishte ndër mend të pushonte. Dritaret e fshatit nga dritat e dobëta të kandilit dukeshin edhe më të zbeta. Shiu i dendur i lante ato.

Në shtëpinë e tyre qante foshnja. Qante ai «doçi» dhe e mbushte shtëpinë me të qara sikur të donte t'u thoshte të gjithë atyre që e dëgjonin: «Jam unë; jam ai, që linda në Pepel».

Dhe dritaret e zbeta bisedonin me njëra-tjetrën për doçin, për nënën e doçit, për vëllezërit, për atë që kishte turpëruar motrën e tyre. Kush ishte ky? Dritaret e zbeta që laheshin nga shiu i shkelnin syrin njëra-tjetrës, bënë lloj-lloj supozimesh për atë që kishte turpëruar motrën e tyre dhe që së shpejti duhej vrarë...

Nga rruga e sipërme e fshatit po vareshin nëpër muzg dy vëllezërit. Ecnin nëpër shi kokëulur.

Ai, vëllai që ruante dhentë, për herë të parë vinte në shtëpi pas atij turpi që kishte bërë motra e tyre. Ecte kokëvarur dhe herë-herë shikonte dritaret e zbeta të fshatit. Edhe dritaret e shikonin atë, dukej sikur pëshpërisnin: «U kthye dhe ai... E hëngrën turpin me bukë».

Nata derdhte shi. Ishte një natë e qullur. Dëgjohesh e lehura e ngjirur e ndonjë qeni. Edhe e lehura e qenit dukej e qullur, e zbetë, një e lehur e zgjatur sikur ndillte kob.

Ata hynë në oborr. Doçi qante. Ata hynë në korridorin e qullur dhe çobanit i therën në zemër të qarët e doçit.

Atje i priti vëllai i madh, i ngrysur, tmerrësisht i ngrysur. U futën në kuzhinë.

U ndez një kandil. Dritarja e vogël e kuzhinës hapi syrin e zbetë.

Atje rreth kandilit që tymoste pak dritë të zbetë u mblodhën katër vëllezërit kokë më kokë, ndërsa nata derdhte dhe derdhte shi.

Vonë fare, kur nata dhe shiu kishin mbuluar gjithshka u dëgjua një zë jo shumë i fortë por i prerë.

— Jo, jo, jo!

Ishte zëri i vëllait të vogël që kundërshtonte. Pastaj një pëllëmbë kërciti në fytyrën e tij. Ai përsëri: «Jo, jo, jo!» — Dhe doli duke qarë. Pas tij doli vëllai i mesmë. Ai e kapi në korridor, e mbërtheu mirë prej krahu dhe e ktheu prapë në kuzhinë. Filti i kandilit po mbarohej. Një dritë e vogël luhatej andej-këtej dhe nëpër muret e kuzhinës shfaqeshin hijet e katër vëllezërve, të mëdha, të mëdha, të frikshme si përbindsha.



Mëngjezi erdhi me shi duke zbuluar ngadalë-ngadalë gjymtyrët e fshatit dhe copa mjegulla që ende shinin nëpër të duke vrapuar strehëve të shtëpive dhe majave të pemëve.

Mëngjezi i zuri afër lumit. Përpara ecnin tre vëllezërit e mëdhenj. Ca hapa më pas ecte ajo, motra e tyre.

— Prgatitu se do të të shpiem te dajua — i kishte thënë vëllai i mesmë. — Atje do të rrish ca kohë...

— Kur? — kishte pyetur motra me drojtje dhe me mosbesim.

— Tani. Që tani. Merr ç'të duhen se do të nisemi.

Dhe ajo ishte bindur verbërisht. Kishte marrë ca lecka për foshnjen, trikon e saj dhe kishte ngarkuar djepin me foshnjen e saj që flinte. Foshnja flinte çuditërisht e qetë.

Kur ishin nisur, vëllai i vogël kishte qarë. Kishte qarë shumë në vetmi dhe siç dukej nuk do ta shqëronte motrën për te dajua. Pastaj ai ishte nisur pas tyre. I vetëm.

Binte një shi i hollë jo i rrëmbyer.

Tashmë dëgjohej nga afër oshëtima e lumit si rënkim.

Foshnja filloi të qante dhe nënës sikur ju këput diçka nga gjoksi që u zgjua kaq shpejt. Foshnja donte të pinte.

Vëllai i madh diç kishte thënë nëpër dhëmbë.

Vëllai i vogël ja arriti motrës. Qëndroi pak në krah të saj, hoqi xhaketën e tij dhe ja hodhi motrës në shpatulla. Ja rregulloi mirë atje që të mos lagej as ajo as foshnja në djep që tani qante me tërsëllimë.

Ai vuri re që motra ishte e bukur por dukej e zbetë në fytyrë. Ajo që dobësuar shumë dhe sikur i dalloheshin ato tiparet e zeshka, të holla. Një dhembje e thellë e sëmboi në zemër...

Pastaj hodhi hapat para nga vëllezërit...

Foshnja qante, thua jse ulërinte me gulçim sikur t'i merrej fryma në moment.

Foshnja donte të pinte. Nëna këtë e dinte. Donte të ulej atje në mes të shiut, t'i jepte gjë asaj krijese që po torturohej. Ç'qenë ata shpirtkazëm që e shikonin aq egër dhe s'e linin të ushqente fëmijën?! Befas ndjeu urrejtje për të vëllezërit, për Filipin, për gjithë botën. . . Po, edhe për Filipin.

Lumi ushtonte egër. Herë-herë vinte oshëtima e ndonjë gjëmimi të thellë.

Foshnja qante. Qante dhe shpirti i nënës. Qante nëna që tani urrente gjithë botën.

Befas vëllai i vogël u kthye dhe qëndroi.

— Jepi të pijë — tha — qëndro atje diku dhe jepi të pijë. Gruaja qëndroi. Shkarkoi djepin dhe e mbuloi foshnjën me trup. Gjiri e shpoi. Ajo ndjeu qumshtin e ngrohtë, që thithte foshnja. Një çast i lumtur!

Tre vëllezërit qëndruan. I madhi vështroi andej me egërsi.

— Lëre! — i tha i dyti.

— Lëre dreqin! — tha dhe i treti.

Vëllai i madh i bëri lëshimin e parë së motrës.

Për pak ajo e ngarkoi djepin në shpinë, rregulloi xhakëtën e vëllait mbi djep dhe u nis me hapa të shpejtë.

Vëllai i vogël kishte kaluar urën tutje. Të tjerët ndaluan hapat dhe i thanë së motrës:

— Kalo para!

Ajo nxitoi hapat. Ata të tre shkuan pas saj.

Lumi gjëmonte dhe të kalite frikën me madhështinë e tij. Copa kërcunjsh dhe degë pemësh binte tëposhtë me kuje. Gruaja hipi në tabanin e urës. Pas saj u ndjenë hapat e rëndë të atyre tre bu-

rrave. Edhe pak. Edhe pak. Edhe një hop, edhe një, edhe një edhe një...

«Dale dhe pak, i thoshte vetes vëllai i madh, edhe pak. Atje në mes të urës... te dallga e madhe... Kuçka!»

Dy vëllezërve të tjerë nuk u bënë këmbët. Ai vëllai që ishte çoban ndjeu një lodhje të madhe në trup e në zemër. Dukej sikur do të binte përdhe.

Krejt papritmas, nga poshtë urës, dha ballë Filipi.

— Nxito Marta, Marta, nxito se do të të hedhin nga ura! — bërtiti Filip Duri.

Filipi nuk kishte fjetur atë natë. E kishte shqetësuar drita e ndezur e kuzhinës dhe ai kishte përgjuar tërë natën në shi. Shumë herë u mat të hynte brenda po nuk guxoi.

Dhe ja krejt papritmas ai u doli përpara vëllezërve.

Vëllezërit mbetën për një çast të shtangur.

— Mos e hidhni! Ajo është gruaja ime!

Vëllezërit panë njëri-tjetrin të habitur.

Befas vëllai i madh i ra me pëllëmbë Filipit.

Një pëllëmbë e fortë si e goditur sëpate.

Filipi u lëkund po nuk ra. Vëllai i madh ju vërvit përsipër me egërsi. Të dy u rrokën me forcë për ta shembur shoshoqin.

Motra lëshoi një ulërimë dhe bashkë me vëllanë e vogël u turrën me vrap tek ata.

Filipit i kërceu një curril gjaku nga qafa. Vëllai i madh e kishte kafshuar keq.

Vëllai i vogël u vërsul për t'i ndarë me tërë forcën. Atë e goditi një shqelm i fortë i të vëllait në bark.

— Lëreni, lëreni, ai është burri im — bërtiste me lemeri e motra.



Dy vëllezërit e tjerë u futën që t'i ndanin. Ata të tre ishin mbërthyer aq keq, sa dukeshin sikur nuk do të shpëtonin gjallë. Filipi mbahej i fortë. Ku e gjente gjithë atë forcë!?

Vëllai i madh bënte ca përpjekje të forta, të rënda. Ai qëllonte Filipin, të vëllezërit, tamam si i tërbuar.

Pastaj atë e kapën të vëllezërit fort.

— Lëre ta marrë dreqi, lëre! — tha çobani.

Vëllai i madh kërkonte të ikte nga krahët e tyre.

— Kuçka! Kuçka! — bërtiste ai.

Filipi i zverdhur u ul te një gur i lagur.

Vëllai i madh bëri dhe një përpjekje për t'u ikur nga krahët. Ai deshi t'i vërsulej së motrës. Filipi u ngrit prapë më këmbë..

Ata e mbanin fort, thuajse e mbanin peshë, tek largoheshin nëpër shi..

Filipi me Martën panë njëri-tjetrin në sy. Një rreze besimi dhe shprese ndriste tek ata sy çuditërisht të ndezur. Filluan të ecnin duke lënë prapa dallgët e lumit që përplaseshin brigjeve me rrëmbim, ashtu të fryra, të turbulla dhe tërë shkumë.